

BASHKIMI
EVROPIAN
SQARON

Si funksionon Bashkimi Evropian

Udhëzuesi juaj
për institucionet
e BE-së



Bashkimi Evropian



BASHKIMI EVROPIAN SQARON

Ky botim është pjesë e botimeve që shtjellojnë në mënyrë të qartë se çfarë bën BE-ja në fushën e politikave të ndryshme, përse BE-ja përfshihet dhe cilat janë rezultatet. Mund të shihni cilat nga këto janë në dispozicion onlajn dhe mund t'i shkarkoni:

europa.eu/pol/index_en.htm

Si funksionon BE-ja ✘

Evropa 2020 — Strategjia e Evropës për zhvillim
Themeluesit e BE-së

Bujqësia
Buxheti

Ndryshimi i klimës

Konkurrenca

Konsumatorët

Dogana

Kultura, audiovizualiteti, sporti

Zhvillimi dhe bashkëpunimi

Agjenda digjitale

Unioni ekonomik dhe monetar dhe euroja

Arsimi, trajnimi, rinia

Punësimi dhe çështjet sociale

Energjia

Zgjerimi

Ndërmarrja

Mjedisi

Marrëdhëniet e jashtme /Politika e jashtme dhe e sigurisë

Tregtia e jashtme

Lufta kundër mashtrimit

Peshkataria dhe çështjet detare

Siguria e ushqimit

Ndihma humanitare

Tregu i brendshëm

Drejtësia, shtetësia, të drejtat fundamentale

Migracioni dhe azili

Shëndeti publik

Politika rajonale

Hulumtimi dhe inovacioni

Siguria dhe çështjet e brendshme

Tatimet

Transporti

Bashkimi Evropian sqaron — Si funksionon Bashkimi Evropian

Komisioni Evropian
Drejtoria Gjenerale për Komunikim
Publikime
1049 Bruksel
BELGJIKË

Doracaku u përfundua në korrik 2012

Cover: © Luis Pedrosa

40 pp. — 21 × 29.7 cm
ISBN 978-92-79-29387-0
doi:10.2770/10657

Luksemburg: Zyra për Publikime e Bashkimit Evropian,
2012

© Bashkimi Evropian, 2012

Riprodhimi është i autorizuar. Për çdo përdorim ose riprodhim të fotografive të veçanta, duhet të kërkohet leje drejtpërsëdrejti nga mbajtësit e të drejtave autoriale.

Shtypur në ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

BASHKIMI EVROPIAN
SQARON

Si funksionon Bashkimi Evropian

Udhëzuesi juaj
për institucionet
e BE-së

Përmbajtja

Prezantimi i Bashkimit Evropian: si funksionon, kush çfarë bën	3
Parlamenti Evropian: zëri i popullit	9
Këshilli Evropian: vendosja e strategjisë	12
Këshilli: zëri i Shteteve Anëtare	14
Komisioni Evropian: promovimi i interesave të përbashkëta	19
Parlamentet nacionale: zbatimi i subsidiaritetit	23
Gjykata e Drejtësisë: respektimi i ligjit të BE-së	24
Banka Qendrore Evropiane: sigurimi i stabilitetit të çmimeve	26
Gjykata e Auditorëve: ndihma për të përmirësuar menaxhimin financiar të BE-së	29
Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social: zëri i shoqërisë civile	31
Komiteti i Rajoneve: zëri i pushtetit lokal	33
Avokati i Popullit Evropian: shqyrtimi i ankesave tuaja	34
Mbikqyrësi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave: mbrojtja e privatësisë suaj	35
Banka Evropiane e Investimeve: investim në të ardhmen	36
Agjencitë e BE-së	38

Prezantimi i Bashkimit Evropian

Si funksionon, kush çfarë bën

Çfarë përmban ky publikim

Ky publikim është udhëzues mbi funksionimin e Bashkimit Evropian (BE). 'Si funksionon BE-ja': si merren vendimet në nivel të BE-së dhe kush i merr këto vendime. Në thelb të këtij procesi të vendim-marrjes janë institucionet e BE-së — siç është Parlamenti, Këshilli dhe Komisioni Evropian — të cilat mund t'i keni dëgjuar, dhe institucione të tjera. Për të sqaruar se si funksionon BE-ja, ky publikim fillimisht sqaron si është bërë legjislacioni i BE-së. Pastaj pasqyron secilin nga institucionet e BE-së, si dhe agjencitë dhe organet që i mbështesin ato.

Bashkimi Evropian në pika të shkurta

Në thelbin e BE-së janë Shtetet Anëtare — 27 vendet që i përkasin Unionit — dhe qytetarët e tyre. Karakteristika unike e BE-së është se, krahas sovranitetit dhe pavarësisë të të gjitha këtyre vendeve, ato kanë bashkuar një pjesë të 'sovranitetit' të tyre, në mënyrë që të fitojnë fuqinë dhe përfitimet e madhësisë. Bashkimi i sovranitetit, në praksë do të thotë se Shtetet Anëtare delegojnë një pjesë të kompetencave të tyre vendim-marrëse në institucionet e tyre të përbashkëta që ata kanë krijuar, në mënyrë që vendimet për çështje specifike me interes të përbashkët, mund të bëhen në mënyrë demokratike në nivel evropian. Kështu, BE-ja qëndron diku mes sistemit të plotë federal si ai i Shteteve të Bashkuara dhe sistemit të lirshëm të bashkëpunimit ndërqeveritar si ai i Kombeve të Bashkuara.

BE-ja ka arritur shumë që nga krijimi i vet në vitin 1950. Ka krijuar tregun e vetëm të mallërave dhe shërbimeve që përfshin 27 vende me rreth 500 milionë qytetarë, të cilët janë të lirë të lëvizin dhe të vendosen aty ku dëshirojnë. Krijoi valutën e përbashkët — euron — tani një nga valutat kryesore në botë, e cila e bën tregun e vetëm më efikas. BE-ja është gjithashtu furnizuesi më i madh botëror i programeve për zhvillim dhe ndihmë humanitare. Këto janë vetëm disa nga arritjet e deritanishme. Për të ardhmen, BE-ja është duke punuar për ta nxjerrë Evropën nga kriza e tanishme ekonomike. BE-ja kryeson luftën kundër ndryshimit të klimës dhe pasojat e këtyre ndryshimeve; meqë ka në plan të rritet,

ju ndihmon vendeve fqinje të përgatiten për anëtarësim në BE; është duke ndërtuar një politikë të përbashkët të jashtme, e cila do të ndihmojë në shtrirjen e vlerave evropiane në mbarë botën. Suksesi i këtyre ambicioneve varet nga aftësia për të marrë vendime efikase dhe në kohë, si dhe aftësia për t'i implementuar ato mirë.

Traktatet e BE-së

Bashkimi Evropian është i bazuar në sundimin e ligjit. Kjo do të thotë se çdo veprim i ndërmarrë nga BE-ja bazohet në traktatet e miratuara vullnetarisht dhe demokratikisht nga të gjitha vendet e BE-së. Traktatet negocohen dhe miratohen nga të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së dhe pastaj ratifikohen nga parlamentet e tyre ose me referendum.

Traktatet përcaktojnë synimet e Bashkimit Evropian, rregullat e institucioneve të BE-së, si merren vendimet dhe marrëdhëniet midis BE-së dhe Shteteve Anëtare. Këto ndryshohen gjithnjë kur bashkohen Shtete të reja Anëtare. Herë pas here, ato janë ndryshuar edhe për të



Më 9 maj 1950, Ministri Francez i Punëve të Jashtme Robert Shuman, për herë të parë publikisht propozoi idetë që çuan rejt Bashkimit Evropian. Kështu, 9 maji kremtohet si ditëlindja e BE-së

reformuar institucionet e Bashkimit Evropian dhe për t'i dhënë atij fusha të reja të përgjegjësisë.

Traktati i fundit i ndryshuar — Traktati i Lisbonës — u nënshkrua në Lisbonë më 13 dhjetor 2007, dhe hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009. Traktatet e hershme janë të përfshira në versionin e tanishëm të konsoliduar, të cilin e përbëjnë Traktati për Bashkimin Evropian dhe Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian.

Traktati për Stabilitet, Koordinim dhe Qeverisje në Unionin Ekonomik dhe Monetar është një traktat ndërqeveritar që u nënshkrua nga të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së, përveç Republikës Çeke dhe Britanisë së Madhe në mars të vitit 2012. Traktati është i përpiluar që të nxisë disiplinën buxhetore, të përforcojë koordinimin e politikave ekonomike dhe për të përmirësuar qeverisjen e euro zonës. Aktualisht, 17 vende të BE-së shfrytëzojnë euron si monedhën e tyre.

Traktati shpesh është përmendur si 'kontrata fiskale' dhe do të hyjë në fuqi më 1 janar 2013, nëse 12 anëtarët e euro zonës e ratifikojnë deri në këtë datë.

Nuk është traktat i BE-së por një traktat ndërqeveritar dhe synon që përfundimisht të bëhet pjesë e ligjit të BE-së



Puna e BE-së bazohet në traktatet e miratuara nga të gjitha vendet anëtare – azhurnimi i fundit kryesor u nënshkruajt në Lisbonë në 2007.

© ImageGlobe

Një histori e traktateve të BE-së

Kur ministri i jashtëm francez Robert Schuman propozoi integrimin e industrive të Evropës perëndimore për thëngjill dhe çelik në vitin 1950, idetë e tij u përcaktuan në Traktatin e Parisit vitin e ardhshëm dhe ishin shenjë paralajmëruese për lindjen e BE-së — Komunitetit Evropian për Thëngjill dhe Çelik. Që atëherë, BE-ja ka azhurnuar dhe ka shtuar rregullisht traktatet për të siguruar politikë dhe vendim-marrje efektive:

- ▶ *Traktati i Parisit, i cili themeloi Këshillin Evropian për Thëngjill dhe Çelik, u nënshkrua në Paris më 18 prill 1951 dhe hyri në fuqi në vitin 1952. Traktati skadoi në vitin 2002.*
- ▶ *Traktatet e Romës që themeluan Komunitetin Ekonomik Evropian (KEE) dhe Komunitetin Evropian për Energji Atomike (Euratom), u nënshkruajtën në Romë më 25 mars 1957 dhe hynë në fuqi në vitin 1958.*
- ▶ *Akti i Vetëm Evropian u nënshkrua në shkurt 1986 dhe hyri në fuqi në vitin 1987. Ai ndryshoi Traktatin e KEE-së dhe trasoi rrugën për kompletimin e tregut të vetëm.*
- ▶ *Traktati i Bashkimit Evropian — Traktati i Mاستrihtit — u nënshkrua në Mاستriht më 7 shkurt 1992 dhe hyri në fuqi në vitin 1993. Ai themeloi Bashkimin Evropian, i dha Parlamentit më tepër kompetenca në vendim-marrje dhe shtoi fusha të reja të politikave për bashkëpunim.*
- ▶ *Traktati i Amsterdimit u nënshkrua më 2 tetor 1997 dhe hyri në fuqi 1999. Ai i ndryshoi traktatet e mëparshme.*
- ▶ *Traktati i Nicës u nënshkrua 26 shkurt 2001 dhe hyri në fuqi në vitin 2003. Ai modernizoi sistemin institucional të BE-së, që të mund të vazhdojë të punojë me efikasitet pas valës së re të Shteteve Anëtare në 2004.*
- ▶ *Traktati i Lisbonës u nënshkrua më 13 dhjetor 2007 dhe hyri në fuqi në vitin 2009. Ky traktat thjeshtësoi metodat e punës dhe rregullat e votimit, krijoi pozitën e Presidentit të Këshillit Evropian dhe prezantoi struktura të reja me qëllim që të bëjë BE-në aktor më të fuqishëm në skenën botërore.*

Kush i merr vendimet?

Vendim-marrja në nivel të BE-së involvon institucione të ndryshme evropiane, veçanërisht:

- ▶ **Parlamenti Evropian**, i cili përfaqëson qytetarët e BE-së dhe zgjidhet drejtpërsëdrejti nga ata;
- ▶ **Këshilli Evropian**, i cili përbëhet nga Shefat e Qeverive dhe Shteteve Anëtare të BE-së;
- ▶ **Këshilli**, i cili përfaqëson qeveritë e Shteteve Anëtare të BE-së;
- ▶ **Komisioni Evropian**, i cili përfaqëson interesat e BE-së në tërësi.

Këshilli Evropian përcakton drejtimin e përgjithshëm politik dhe prioritetet e BE-së mirëpo nuk ushtron funksionet legjislative. Në përgjithësi, është komisioni Evropian që propozon ligje të reja kurse Parlamenti Evropian dhe Këshilli janë ata që i miratojnë ato. Shtetet Anëtare dhe Komisioni, pastaj i zbatojnë ato.

Çfarë lloje të legjislacionit ekzistojnë?

Ka disa lloje të akteve ligjore të cilat zbatohen në mënyra të ndryshme:

- ▶ **Rregullorja** është një ligj që është i zbatueshëm dhe i obligueshëm në të gjitha Shtetet Anëtare drejtpërsëdrejti. Ajo nuk duhet të kalojë në ligj nacional nga Shtetet Anëtare, edhe pse, për t'iu shmangur konfliktit me rregulloren, mund të ketë nevojë që të ndryshohen ligjet nacionale.

▶ **Direktiva** është një ligj që obligon Shtetet Anëtare, ose një grup Shtetesh Anëtare, të arrijnë një synim të caktuar. Zakonisht, direktivat duhet të zhvendosen në një ligj nacional për t'u bërë efektive. Nënkuptoet se një direktivë përcakton rezultatin që duhet arritur: varet nga secili Shtet Anëtar veçmas të vendosë se si ta bëjë këtë.

▶ Një **vendim** mund t'i drejtohet Shteteve Anëtare, një grupi njerëzish, ose madje edhe individësh. Ai është plotësisht detyrues. Vendimet shfrytëzohen, për shembull, të vendosin lidhur me bashkimet e propozuara midis ndërmarrjeve.

▶ **Rekomandimet** dhe **opinionet** nuk kanë fuqi detyruese.

Si kalohet legjislacioni?

Çdo ligj evropian bazohet në një nen të veçantë të traktatit, të ashtuquajtur 'baza ligjore' e legjislacionit. Kjo përcakton se cilat procedura legjislative duhet të ndiqen. Traktati përcakton procesin e vendim-marrjes, duke përfshirë edhe propozimet e Komisionit, leximet e njëpasnjëshme të Këshillit dhe Parlamentit, si dhe opinionet e organeve këshilluese. Ai gjithashtu cakton kur është i nevojshëm unanimiteti, dhe kur është e mjaftueshme mazhoranca që Këshilli të miratojë legjislacionin.


Pjesa më e madhe e legjislacionit të BE-së miratohet me shfrytëzimin e **'Procedurës së zakonshme legjislative'**. Në këtë procedurë, Parlamenti dhe Këshilli ndajnë pushtetin legjislativ.



© Heide Benser/Corbis

Liria e të gjithë qytetarëve për të udhëtuar dhe punuar në të gjitha 27 vendet e BE-së, është një nga arritjet kryesore të Bashkimit Evropian.

PROCEDURA E ZAKONSHME LEGJISLATIVE



(*) Këshilli miraton qëndrimin e vet me anë të mazhorancës së kualifikuar (traktatet sigurojnë unanimitet në disa fusha të veçanta). Mirëpo, nëse Këshilli ka në plan të devijojë nga propozimi/opinionet e Komisionit, ai miraton qëndrimin e vet me unanimitet.

Procedura fillon me Komisionin. Kur merret parasysh nisja e një propozimi për veprim, Komisioni shpesh kërkon pikëpamje mbi këtë temë nga qeveritë, bizneset, shoqëria civile dhe individët. Mendimet e grumbulluara përfshihen në propozimin e Komisionit që prezantohet para Këshillit dhe Parlamentit. Propozimi mund të jetë bërë me kërkesë të Këshillit, Këshillit Evropian, Parlamentit ose qytetarëve evropianë, ose me vet iniciativën e Komisionit.

Këshilli dhe Parlamenti lexojnë dhe diskutojnë propozimin. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje gjatë leximit të dytë, propozimi i jepet një 'komiteti të pajtimit', i cili përbëhet nga numër i barabartë i përfaqësuesve të Këshillit dhe Parlamentit. Përfaqësuesit e Komisionit marrin pjesë gjithashtu në mbledhjet e komitetit dhe kontribuojnë në diskutim. Pasi komiteti të ketë arritur një marrëveshje, teksti i dakorduar i dërgohet Parlamentit dhe Këshillit për leximin e tretë, në mënyrë që të miratohet përfundimisht si ligj. Në shumicën e rasteve, Parlamenti voton propozimet me mazhorancë të thjeshtë kurse Këshilli me mazhorancë të kualifikuar, ku secili Shtet Anëtar ka një numër të caktuar të votave varësisht nga madhësia dhe popullata e tij. Në disa raste, në Këshill kërkohet votimi unanim.

Procedurat speciale

Procedurat e veçanta legjislative janë në dispozicion varësisht nga tema e propozimit. Gjatë **Procedurës së konsultimit**, Këshilli duhet të konsultohet me Parlamentin lidhur me një propozim të Komisionit, por nuk është e nevojshme të pranojë këshillën e Parlamentit. Kjo procedurë është e zbatueshme vetëm në disa fusha, siç janë përjashtimet e tregut të brendshëm dhe ligji i konkurrencës. Në **Procedurën e pëlqimit**, Parlamenti mund të pranojë ose të refuzojë një propozim, por nuk mund të propozojë amendamente. Kjo procedurë mund të përdoret kur propozimi ka të bëjë me miratimin e një traktati ndërkombëtar që ka qënë i negociuar. Përveç kësaj, ka raste të pakta ku Këshilli dhe Komisioni ose vetëm Komisioni mund të kalojnë legjislacion.

Kush mund të konsultohet, kush mund të kundërshtojë?

Krahas trekëndëshit Komision–Këshill–Parlament, ekziston një numër i organeve që duhet të konsultohen kur legjislacioni i propozuar përfshin fushën e tyre të interesimit. Edhe nëse nuk merret këshilla e këtyre organeve, është një kontribut për mbikqyrjen

demokratike të legjislacionit të BE-së që siguron se ky legjislacion i nënshtrohet shqyrtimit të kujdesshëm.

Këto organe janë:

- **Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social**, i cili përfaqëson grupet e shoqërisë civile siç janë punëdhënësit, sindikatat dhe grupet e interesit social;
- **Komiteti i Rajoneve**, i cili garanton që merret parasysh roli i pushtetit lokal dhe rajonal

Veç kësaj, institucione dhe organe të tjera mund të konsultohen atëherë kur një propozim i përket fushës së tyre të interesimit ose ekspertizës. Për shembull, Banka Qendrore Evropiane do të duhej të konsultohet lidhur me propozime që kanë të bëjnë me çështje ekonomike ose financiare.

Pjesëmarrja e qytetarëve

Me anë të një 'Iniciativë Qytetare Evropiane', 1 milionë qytetarë të BE-së, të paktën nga një e katërta e vendeve të BE-së, mund të kërkojnë nga Komisioni të nxjerrë një propozim legjislativ për një çështje të caktuar. Komisioni do të shqyrtojë me kujdes të gjitha iniciativat që bien në kuadër të kompetencave të tij dhe që janë mbështetur nga 1 milionë qytetarë. Audicioni i iniciativave bëhet në Parlament. Për këtë arsye, iniciativat e tilla mund të ndikojnë në punën e institucioneve të BE-së, si dhe në debatin publik.



Qytetarët tani mund të propozojnë ligje të reja, me anë të Iniciativës Qytetare Evropiane.

Mbikqyrja nacionale

Parlamentet nacionale pranojnë propozim akte legjislative në të njëjtën kohë me Parlamentin Evropian dhe Këshillin. Ato mund të japin mendimin e tyre për të siguruar që vendimet janë marrë në nivelin më të përshtatshëm. Veprimet e BE-së i nënshtrohen parimit të **subsidiaritetit** — që do të thotë se, përveç në fushat ku ka kompetenca ekskluzive, Unioni vepron vetëm në rastet kur veprimi është më efektiv në nivel të BE-së se sa në nivel nacional. Prandaj, parlamentet nacionale monitorojnë zbatimin e pagabueshëm të këtij parimi në vendim-marrjen e BE-së.

Çfarë vendimesh merren

Traktatet shënojnë fushat e politikave në të cilat BE-ja mund të marrë vendime. Në disa fusha, BE-ja ka **kompetencë ekskluzive**, që do të thotë se vendimet merren në nivel të BE-së gjatë mbledhjeve të Shteteve Anëtare në Këshill dhe në Parlamentin Evropian. Këto fusha të politikës përfshijnë doganat, rregullat e konkurrencës, politikën monetare për euro zonën dhe ruajtjen e peshqve dhe tregtisë.

Në fushat e tjera të politikës, **kompetencat e vendim-marrjes** i ndajnë Unioni dhe Shtetet Anëtare. Kjo do të thotë se, nëse legjislacioni është miratuar në nivel të BE-së, atëherë këto ligje kanë prioritet. Mirëpo, nëse ndonjë legjislacion nuk miratohet në nivel të BE-së, atëherë Shtetet Anëtare mund të nxjerrin ligje në nivel nacional. Kompetenca e përbashkët zbatohet në shumë fusha politikash, siç janë tregu i brendshëm, bujqësia, mjedisi, mbrojtja e konsumatorëve dhe transporti.

Në të gjitha fushat e tjera të politikës, vendimet u mbeten Shteteve Anëtare. Prandaj, nëse në traktat nuk është cituar ndonjë fushë politike, Komisioni nuk mund të propozojë ndonjë ligj në këtë fushë. Megjithatë, në disa fusha, siç është sektori i hapësirës, arsimit, kulturës dhe turizmit, Unioni mund të mbështesë përpjekjet e Shteteve Anëtare. Kurse në fusha të tjera si ndihma e huaj dhe kërkimi shkencor, BE-ja mund të kryejë aktivitete paralele, siç janë programet për ndihmë humanitare.

Koordinimi ekonomik

Të gjitha shtetet e BE-së janë pjesë e Unionit Ekonomik dhe Monetar (EMU), që do të thotë se ato koordinojnë politikë-bërjen e tyre ekonomike dhe trajtojnë vendimet ekonomike si çështje të interesit të përbashkët. Përbrenda Unionit Ekonomik dhe Monetar, asnjë institucion nuk mund të jetë përgjegjës i vetëm për politikën e përgjithshme ekonomike. Këto përgjegjësi janë të ndara midis Shteteve Anëtare dhe institucioneve të BE-së.

Politika monetare — e cila trajton stabilitetin e çmimeve dhe kamatat — menaxhohet pavarësisht nga Banka Qendrore Evropiane (ECB) në euro zonë, d.m.th. në ato 17 vende të cilat përdorin euron si monedhën e tyre.

Politika fiskale — e cila ka të bëjë me vendimet mbi tatimin, shpenzimet dhe huamarrjen — është përgjegjësi e 27 qeverive të Shteteve Anëtare. E njëjta vlen edhe për politikën e punës dhe mirëqenies. Mirëpo, pasi që vendimet fiskale të vetëm një Shteti Anëtar të euro zonës mund të kenë ndikim në mbarë zonën e euros, këto vendime duhet të jenë në pajtim me rregullat e përcaktuara në nivel të BE-së. Prandaj, koordinimi i financave të shëndosha publike dhe politikave strukturore është i nevojshëm, në mënyrë që EMU të funksionojë në mënyrë efektive dhe të sigurojë stabilitet dhe zhvillim. Në veçanti, kriza ekonomike që filloi në vitin 2008, theksoi nevojën për të forcuar qeverisjen ekonomike në BE dhe në zonën e euros, ndër të tjera edhe me anë të koordinimit më të afërt të politikave, vëzhgimin dhe mbikqyrjen e tyre.

Këshilli i vëzhgon financat publike dhe politikën ekonomike të Shteteve Anëtare dhe mund të japë rekomandime për vende individuale të BE-së, në bazë të propozimeve të Komisionit. Këshilli mund të rekomandojë masa rregulluese dhe mund të saksionojë vendet e euro zonës që nuk ndërmarrin masa korrigjuese për të zvogëluar deficitin e tepruar dhe nivelet e borxhit.

Qeverisja me zonën e euros dhe reformat e mëdha në politikën e ekonomisë diskutohen në Euro Samite, ku takohen krerët e shteteve ose qeverive të anëtarëve të zonës euro.

BE dhe marrëdhëniet e jashtme

Marrëdhëniet me vendet jashtë BE-së janë nën përgjegjësinë e Përfaqësuesit të Lartë të Unionit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, i cili emërohet nga Këshilli Evropian, por i cili mban edhe postin e zëvendës-presidentit të Komisionit Evropian. Në nivel të krerëve të shteteve dhe qeverive, Unioni përfaqësohet nga Këshilli Evropian.

Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm (EEAS) shërben si ministri i jashtëm dhe shërbim diplomatik i Bashkimit Evropian nën autoritetin e Përfaqësuesit të Lartë. Ky shërbim përbëhet nga stafi profesional i transferuar nga Këshilli, Shtetet Anëtare dhe Komisioni Evropian.

Këshilli zhvillon dhe merr vendime në fushën e punëve të jashtme dhe politikës të sigurisë të BE-së, në bazë të udhëzimeve të përcaktuara nga Këshilli Evropian. Ndërsa Komisioni, është përgjegjës për tregtinë dhe financimin për vendet jo anëtare të BE-së, siç janë ndihmat humanitare apo ndihmat për zhvillim. Komisioni gjithashtu e përfaqëson Unionin në të gjitha fushat e kompetencës së BE-së jashtë politikës së jashtme dhe të sigurisë.

Parlamenti Evropian

Zëri i popullit

Roli: Arma legjislative e BE-së e zgjedhur drejtpërsëdrejti

Anëtarë: 754 Deputetë të Parlamentit Evropian

Vendi: Strazburg, Bruksel dhe Luksemburg

► www.europarl.eu

Deputetët e Parlamentit Evropian (MEP) zgjidhen direkt nga qytetarët e BE-së për të përfaqësuar interesat e tyre. Zgjedhjet mbahen çdo pesë vjet dhe të gjithë qytetarët e BE-së mbi 18 vjeç (16 në Austri) — rreth 375 milionë — kanë të drejtë të votojnë. Parlamenti ka 754 deputetë nga të gjitha 27 Shtetet Anëtare.

Selia zyrtare e Parlamentit Evropian është në Strazburg (Francë), edhe pse institucioni ka tre vende të punës: Strazburg, Bruksel (Belgjikë) dhe Luksemburg. Mbledhjet kryesore të Parlamentit në tërësi, të quajtura 'seanca plenare', mbahen në Strazburg 12 herë në vjet. Seancat plotësuese plenare mbahen në Bruksel. Mbledhjet e Komiteteve mbahen poashtu në Bruksel.

Përbërja e Parlamentit Evropian

Ulëset në Parlamentin Evropian ndahen midis Shteteve Anëtare në bazë të pjesës së tyre të popullatës në BE.


Kroacia do të bëhet Shteti i 28 Anëtar i Bashkimit Evropian më 1 korrik 2013. Në momentin e anëtarësimit, 12 deputetë kroatë do të hyjnë në Parlamentin Evropian deri në fund të këtij mandati parlamentar. Për zgjedhjet e Parlamentit në vitin 2014, numri i përgjithshëm i deputetëve të PE-së do të ndryshohet në 751.

Numri më i madh i deputetëve në PE janë të lidhur me një parti politike nacionale në vendin e tyre. Në Parlamentin Evropian, partitë nacionale grupohen në grupime politike të mbarë BE-së dhe shumica e deputetëve të PE-së i përkasin njëres nga këto.

NUMRI I DEPUTETËVE TË PE PËR SHITET ANËTAR NË 2012

Shteti Anëtar	Numri i deputetëve	Shteti Anëtar	Numri i deputetëve
Austria	19	Letonia	9
Belgjika	22	Lituania	12
Bullgaria	18	Luksemburg	6
Qiproja	6	Malta	6
Republika Çeke	22	Holanda	26
Danimarka	13	Polonia	51
Estonia	6	Portugalia	22
Finlanda	13	Rumania	33
Franca	74	Slovakia	13
Gjermania	99	Slovenia	8
Greqia	22	Spanja	54
Hungaria	22	Suedia	20
Irlanda	12	Britania e Madhe	73
Italia	73	GJITHSEJ	754

NUMRI I DEPUTETËVE TË PE-SË NË SECILIN GRUP POLITIK, NGA PRILLI 2012



Çfarë punon Parlamenti Evropian

Parlamenti ka tre role kryesore:

1. Bashkë me Këshillin, Parlamenti ndan pushtetin e nxjerrjes së ligjeve — kalimin e ligjeve. Fakti se është organ i zgjedhur drejtpërsëdrejti, ndihmon të garantohet legjitimiteti demokratik i ligjit të Evropës.
2. Kryen mbikqyrje demokratike mbi të gjitha institucionet e BE-së, dhe sidomos mbi Komisionin. Ka fuqinë e miratimit ose refuzimit të nominimeve të Presidentit të Komisionit dhe të Komisionerëve dhe të drejtën për të kritikuar Komisionin si tërësi.
3. Bashkë me Këshillin, ndan autoritetin mbi buxhetin e BE-së dhe prandaj mund të ndikojë në shpenzimet e BE-së. Në fund të procedurës buxhetore, ai miraton ose refuzon tërësisht buxhetin.

Këto tre role janë përshkruar më hollësisht në vijim.

1. FUQIA PËR TË NXJERRË LIGJE

Procedura më e zakonshme për miratimin e legjislacionit të BE-së quhet 'procedurë e zakonshme legjislative' — e njohur edhe si 'procedurë e bashkë vendim-marrjes'. Kjo e vendos Parlamentin Evropian dhe Këshillin në pozitë të barabartë, dhe ligjet e kaluara me këtë procedurë janë akte të përbashkëta të Këshillit dhe Parlamentit. Kjo vlen për pjesën më të madhe të legjislacionit të BE-së që përfshin shumë fusha të ndryshme, siç janë të drejtat e konsumatorit, mbrojtja e mjedisit dhe transporti. Sipas procedurës së zakonshme legjislative, Komisioni përgatit një propozim që duhet të miratohet si nga Parlamenti ashtu edhe nga Këshilli. Miratimi i Parlamentit është i nevojshëm për të gjitha

marrëveshjet ndërkombëtare në fushat e përfshira me procedurën e zakonshme legjislative.

Parlamenti duhet të konsultohet lidhur me një numër të madh të propozimeve të tjera. Miratimi i tij është i nevojshëm për vendime të rëndësishme politike ose institucionale, siç janë: siguria sociale dhe aktet e mbrojtjes, dispozitat lidhur me tatimet në fushën e energjisë dhe harmonizimi i taksave të qarkullimit me taksat indirekte. Parlamenti gjithashtu stimulon legjislacionin e ri, duke shqyrtuar programin vjetor të punës të Komisionit, duke marrë parasysh se cilat ligje të reja do të jenë të përshtatshme dhe duke kërkuar nga Komisioni të prezantojë propozime.

2. FUQIA E MBIKQYRJES

Parlamenti ushtron mbikqyrje demokratike mbi institucionet evropiane. Këtë e bën në disa mënyra. Së pari, kur duhet të emërohet Komisioni i ri, Parlamenti teston të gjithë anëtarët e rinj dhe Presidentin e Komisionit (të nominuar nga Shtetet Anëtare). Ata nuk mund të emërohen pa miratimin e Parlamentit.

Veç kësaj, Komisioni është politikisht përgjegjës para Parlamentit, i cili mund të kalojë një 'propozim të cenzurës' duke bërë thirrje për dorëheqjen e tij të plotë. Më në përgjithësi, Parlamenti ushtron kontroll me anë të shqyrtimit të rregullt të raporteve që i dërgohen nga Komisioni dhe me anë të pyetjeve me shkrim dhe me gojë.

Komisionerët marrin pjesë në seancat plenare të Parlamentit dhe në mbledhjet e komiteteve parlamentare. Në mënyrë të ngjashme, Parlamenti ka dialog të rregullt me Presidentin e Bankës Qendrore Evropiane lidhur me politikën monetare.



Martin Schulc u zgjodh President i Parlamentit Evropian në vitin 2012.

Parlamenti gjithashtu monitoron punën e Këshillit: Deputetët e PE-së rregullisht parashtojnë pyetje me shkrim dhe me gojë për Këshillin, kurse Presidenca e Këshillit merr pjesë në seancat plenare dhe inkuadrohet në debate të rëndësishme. Për disa fusha të politikave që përfshijnë punët e jashtme dhe politikën e sigurisë, përgjegjës për vendim-marrje është vetëm Këshilli. Por, megjithatë, Parlamenti punon ngushtë me Këshillin në këto fusha.

Parlamenti mund të ushtrojë edhe kontroll demokratik, me anë të shqyrtimit të peticioneve të qytetarëve dhe me themelimin e komiteteve të veçanta të hetimit.

Së fundi, Parlamenti siguron të dhëna për të gjitha samitet e BE-së (mbledhjet e Këshillit Evropian). Në hapjen e çdo samiti, Presidenti i Parlamentit është i ftuar që të shprehë pikëpamjet dhe shqetësimet e Parlamentit në lidhje me çështjet aktuale dhe me pikat e agjendës së Këshillit Evropian.

3. FUQIA E PORTOFOLIT

Buxheti vjetor i BE-së vendoset bashkërisht nga Parlamenti dhe Këshilli i Bashkimit Evropian. Parlamenti diskuton atë në dy lexime të njëpasnjëshme mirëpo buxheti nuk do të hyjë në fuqi para se të nënshkruhet nga Presidenti i Parlamentit.

Komiteti i tij për Kontroll të Buxhetit mbikqyr shpenzimin e buxhetit dhe çdo vjet, Parlamenti merr vendim nëse do të miratojë administrimin e buxhetit nga Komisioni për vitin paraprak financiar. Ky proces i miratimit është i njohur teknikisht si 'shlyerje'.

Si funksionon Parlamenti

Parlamenti zgjedh Presidentin e vet me mandat prej dy vjet e gjysmë. Presidenti përfaqëson Parlamentin para institucioneve të tjera të BE-së dhe para botës së jashtme. Atë e ndihmojnë 14 zëvendës Presidentë. Presidenti i Parlamentit Evropian, së bashku me Presidentin e Këshillit, nënshkruan të gjitha aktet legjislative pasi që ato të jenë miratuar.

Puna e Parlamentit ndahet në dy faza kryesore:

- ▶ Përgatitja për seancat plenare: këtë e bëjnë Deputetët e PE-së në 20 komitetet parlamentare që specializohen në fusha të veçanta të aktivitetit të BE-së. Për shembull, Komiteti ECON për Çështje Ekonomike dhe Monetare, ose Komiteti INTA për Tregtinë Ndërkombëtare. Çështjet për debat diskutohen edhe nga grupet politike.
- ▶ Seanca plenare: seancat plenare, ku marrin pjesë të gjithë deputetët, zakonisht mbahen në Strasburg (një javë në muaj) dhe ndonjëherë, seancat shtesë mbahen në Bruksel. Në seancat plenare, Parlamenti shqyrton legjislacionin e propozuar dhe voton mbi ndryshimet para se të marrë vendimin për tekstin e plotë. Pikat e tjera të agjendës mund të përfshijnë 'komunikimet' e Këshillit ose Komisionit, ose pyetje në lidhje me atë që po ndodh në BE ose në mbarë botën.

Këshilli Evropian

Vendosja e strategjisë

Roli: Përcakton drejtimin politik dhe prioritetet

Anëtarë: Shefat e Shteteve ose Qeverive të çdo Shteti Anëtar, Presidenti i Këshillit Evropian dhe Presidenti i Komisionit Evropian

Vendi: Bruksel

▶ european-council.europa.eu

Këshilli Evropian bashkon liderët më të rëndësishëm të BE-së, p.sh. Kryeministrat dhe Presidentët, bashkë me Presidentin e vet dhe Presidentin e Komisionit. Ata takohen së paku katër herë në vjet, për t'i dhënë BE-së prioritetet dhe një drejtim të përgjithshëm politik. Në këto mbledhje merr pjesë edhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politikë Sigurie.

Çfarë bën Këshilli Evropian

Si mbledhje samiti për Shefat e Shteteve dhe Qeverive të të gjitha vendeve të BE-së, Këshilli Evropian përfaqëson nivelin më të lartë të bashkëpunimit politik midis Shteteve Anëtare. Gjatë mbledhjeve, liderët marrin vendime me konsensus në lidhje me drejtimin e përgjithshëm dhe prioritetet e Bashkimit Evropian, dhe sigurojnë stimulim e nevojshëm për zhvillimin e tij.

Këshilli Evropian nuk miraton legjislacion. Në fund të çdo mbledhjeje, ai jep 'Konkluzat', të cilat pasqyrojnë mesazhet kryesore që vijnë si rezultat i diskutimeve dhe ndërmerr veprime nga vendimet e arritura, edhe kur bëhet fjalë për vazhdimin e tyre. Konkluzat identifikojnë çështjet më të rëndësishme që duhen trajtuar nga Këshilli, d.m.th. mbledhjet e ministrave. Ata mund të ftojnë gjithashtu edhe Komisionin Evropian që të ofrojë propozime për të trajtuar ndonjë sfidë të caktuar ose mundësi me të cilën përballlet Bashkimi Evropian.

Mbledhjet e Këshillit Evropian mbahen së paku dy herë në çdo gjashtë muaj. Mbledhje plotësuese (të jashtëzakonshme ose joformale) mund të mbahen për të trajtuar çështje urgjente që kanë nevojë për vendime, për shembull në fushën e çështjeve ekonomike ose politikën e jashtme.

Presidenti i Këshillit Evropian

Punën e Këshillit Evropian e koordinon Presidenti i tij, i cili përgjigjet për thirrjen dhe kryesimin e mbledhjeve të Këshillit Evropian dhe avancimin e punës së tij.

Presidenti i Këshillit Evropian gjithashtu përfaqëson Bashkimin Evropian në botën e jashtme. Së bashku me Përfaqësuesin e Lartë për Punë të Jashtme dhe Politikë Sigurie, ai ose ajo përfaqëson interesat e Bashkimit Evropian në çështjet e jashtme dhe ato të sigurisë.

Presidenti zgjidhet nga Këshilli Evropian me mandat dy vjet e gjysmë dhe mund të rizgjidhet vetëm një herë. Presidenca e Këshillit Evropian është punë me orar të plotë; Presidenti nuk mund të ketë njëkohësisht funksion tjetër nacional.

Si i merr vendimet Këshilli Evropian

Këshilli Evropian i merr pothuajse të gjitha vendimet me konsensus. Mirëpo, në disa raste vlen mazhoranca e kualifikuar, si për shembull në rastet e zgjedhjes së Presidentit, emërimit dhe Komisionit dhe Përfaqësuesit të Lartë për Punë të Jashtme dhe Politikë Sigurie.

Kur Këshilli Evropian vendos me votim, të vetmit që mund të votojnë janë Shefat e Shteteve ose Qeverive.

Sekretariati

Këshillin Evropian e ndihmon Sekretariati Gjeneral i Këshillit.

Euro Samiti

Jashtë Këshillit Evropian, Shefat e Shteteve dhe Qeverive të këtyre vendeve, të cilat kanë monedhën e tyre euron – gjithashtu takohen së paku dy herë në vjet, së bashku me Presidentin e Komisionit Evropian. Në këto mbledhje të Euro Samitit ftohet Presidenti i Bankës Qendrore Evropiane. Mund të ftohet edhe Presidenti i Parlamentit Evropian.

Këto mbledhje janë një mundësi për të diskutuar qeverisjen e euro zonës, si dhe reformat kryesore të politikës ekonomike. Euro Samiti formalisht themelohet nga Traktati mbi Stabilitet, Koordinim dhe Qeverisje të Unionit Ekonomik dhe Monetar (TSCG) i cili u nënshkrua nga 25 Shtete Anëtare në vitin 2012 dhe pritet të hyjë në fuqi në 2013. Presidenti i Euro Samitit emërohet nga Shefat e Shteteve ose Qeverive të anëtarëve të euro zonës. Emërimi bëhet në të njëjtën kohë kur bëhet edhe ai i Presidentit dhe Këshillit Evropian, dhe ka kohëzgjatjen e njëjtë. Këto dy pozita mund të mbahen nga personi i njëjtë.

Në disa raste, liderët e shteteve që kanë ratifikuar këtë Traktat por që nuk e përdorin euron si monedhën e tyre,



Herman van Rompuy kryeson samitet e BE-së si President i Këshillit Evropian

gjithashtu marrin pjesë në diskutimet në Euro Samit. Kur këto vende nuk janë të përshtatshme për pjesëmarrje, Presidenti i Euro Samitit i informon ato dhe Shtetet e tjera Anëtare të BE-së rregullisht mbi përgatitjet dhe rezultatet e samiteve.

Një konfuzion i Këshilleve: cili është cili?

Është shumë lehtë të shkaktohet konfuzion lidhur me organet e Evropës — sidomos kur shumë organe të ndryshme kanë emra shumë të ngjashëm, siç janë tre 'Këshillet' në vijim.

▶ Këshilli Evropian

Kjo do të thotë kërret e Shteteve dhe Qeverive (d.m.th. Presidentët dhe/ose Kryeministrat) e të gjitha vendeve të BE-së, bashkë me Presidentin e vet dhe Presidentin e Komisionit Evropian. Ky është organi i nivelit më të lartë të politikë-bërjes në Bashkimin Evropian, dhe prandaj mbledhjet e tij shpesh quhen 'samite'.

▶ Këshilli

I njohur edhe si Këshilli i Ministrave, ky institucion përbëhet nga ministrat e qeverive të të gjitha vendeve të BE-së. Këshilli takohet rregullisht për të marrë vendime të detajuara dhe për të kaluar ligje evropiane.

▶ Këshilli i Evropës

Ky nuk është institucion i BE-së. Është një organizatë ndërqeveritare që ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Ai u themelua në vitin 1949 dhe një nga arritjet e hershme të tij ishte të hartimi i Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Në mënyrë që qytetarët të ushtrorin të drejtat e tyre sipas kësaj Konvente, ai themeloi Gjykatën Evropiane për të Drejta të Njeriut. Këshilli i Evropës tani ka 47 Shtete Anëtare, duke përfshirë të gjitha vendet e BE-së, kurse selinë e ka në Strazburg në Francë.

Këshilli

Zëri i Shteteve Anëtare

Roli: Vendos politikat dhe miraton legjislacion

Anëtarë: Një ministër nga çdo Shtet Anëtar

Vendi: Bruksel dhe Luksemburg

► consilium.europa.eu

Në Këshill, ministrat e Shteteve Anëtare të BE-së takohen të diskutojnë çështjet e BE-së, të marrin vendime dhe të kalojnë ligje. Ministrat që marrin pjesë në këto takime, kanë autoritetin për të angazhuar qeverinë e tyre në veprimet e dakorduara në mbledhjet e Këshillit.

Çfarë bën Këshilli

Këshilli është vendim-marrësi thelbësor i BE-së. Puna e tij kryhet gjatë mbledhjeve të Këshillit ku marrin pjesë nga një ministër prej çdo qeverie nacionale të BE-së. Qëllimi i këtyre takimeve është të diskutohet, dakordohet, ndryshohet dhe në fund, të miratohet legjislacioni; koordinohen politika të Shteteve Anëtare; ose të definohet politika e jashtme e BE-së.

Se cilët ministra marrin pjesë në cilin Këshill, varet nga temat e agjendës — kjo njihet si 'konfiguracioni' i Këshillit. Nëse, për shembull, Këshilli duhet të diskutojë

çështje të mjedisit, në mbledhje do të marrin pjesë ministrat e mjedisit të çdo vendi të BE-së dhe kjo mbledhje njihet si 'Këshilli i Mjedisit'; e njëjta vlen edhe për 'Këshillin e Çështjeve Ekonomike dhe Financiare' ose 'Këshilli i Konkurrencës', dhe ashtu me radhë.

Presidenca e Këshillit qarkullon mes Shteteve Anëtare çdo gjashtë muaj. Kjo nuk duhet të ngatërrohet me Presidentin e Këshillit Evropian. Përgjegjësia e qeverisë që mban Presidencën është të organizojë dhe të kryesojë mbledhje të ndryshme të Këshillit. Me përjashtim, Këshilli i Punëve të Jashtme kryesohet nga Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri, i cili kryen politikën e jashtme në emër të Këshillit.

Në interes të vazhdimësisë të punës të Këshillit, Presidencat gjashtë mujore punojnë së bashku në grupe me nga tre presidenca. Këto ekipe me tre-Presidenca ('trio') hartojnë program të përbashkët të punës së Këshillit për një periudhë 18 mujore.

Vendet e BE-së janë dakorduar për një strategji "Evropa 2020" për atë se si të dalin nga kriza ekonomike me zhvillim të shpejtë, të qëndrueshëm dhe përfshirës. Këshilli i ministrave merr shumë vendime për të zbatuar këtë strategji.



PRESIDENCAT E KËSHILLIT

Viti	Janar–Qershor	Korrik–Dhjetor
2012	Danimarka	Qiproja
2013	Irlanda	Lituania
2014	Greqia	Italia
2015	Letonia	Luksemburgu
2016	Holanda	Slovakia
2017	Malta	Britania e Madhe
2018	Estonia	Bullgaria
2019	Austria	Rumania
2020	Finlanda	

Çdo ministër në Këshill është i autorizuar të angazhojë qeverinë e vet. Gjithashtu, çdo ministër në Këshill përgjigjet para autoriteteve të zgjedhura nacionale. Kjo siguron legjitimitetin demokratik të vendimeve të Këshillit.

Këshilli ka pesë përgjegjësi kryesore::

4. Të kalojë ligjet evropiane. Në shumicën e fushave, ai nxjerr ligje së bashku me Parlamentin Evropian.
5. Të koordinojë politikat e Shteteve Anëtare, për shembull, në fushën e ekonomisë.
6. Të zhvillojë politikën e përbashkët të BE-së për punë të jashtme dhe siguri, në bazë të udhëzimeve të caktuara nga Këshilli Evropian.
7. Të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare mes BE-së dhe një ose më shumë shteteve ose organizatave ndërkombëtare.
8. Të miratojë buxhetin e BE-së, së bashku me Parlamentin Evropian.

Puna e Këshillit është përshkruar hollësisht në vijim.

1. LEGJISLACIONI

Një pjesë e madhe e legjislacionit të BE-së miratohet bashkarisht nga Këshilli dhe Parlamenti. Si rregull i përgjithshëm, Këshilli vepron vetëm mbi propozimet e Komisionit, ndërsa Komisioni zakonisht mban përgjegjësinë për zbatimin e drejtë të legjislacionit të BE-së pas miratimit.

2. KOORDINIMI I POLITIKAVE TË SHTEVEVE ANËTARE (NJË SHEMBULL: POLITIKA EKONOMIKE)

Të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së janë pjesë e Unionit Ekonomik dhe Monetar (EMU) edhe pse nuk i përkasin të gjitha euro zonës. Në suaza të këtij Unioni, politika ekonomike e BE-së bazohet në koordinimin e ngushtë të politikave nacionale. Ky koordinim kryhet nga ministrat e ekonomisë dhe ata të financave, të cilët gjithë së bashku e

përbëjnë Këshillin për Çështje Ekonomike dhe Financiare (Ecofin).

3. POLITIKA E PËRBASHKËT PËR PUNË TË JASHTME DHE SIGURI (CFSP)

Definicioni dhe implementimi i politikës së BE-së për punë të jashtme dhe siguri është kompetenca ekskluzive dhe unanime e Këshillit Evropian dhe Këshillit. Këtë politikë e vë në fuqi Përfaqësuesi i Lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri së bashku me Shtetet Anëtare, në mbledhjet e Këshillit të Punëve të Jashtme.

4. NËNSHKRIMI I MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

Çdo vjet, Këshilli arrin (d.m.th. zyrtarisht nënshkruan) një varg marrëveshje midis Bashkimit Evropian dhe vendeve jashtë BE-së, si dhe me organizata ndërkombëtare. Këto marrëveshje mund të përfshijnë shumë fusha siç janë tregtia, bashkëpunimi dhe zhvillimi; ose mund të trajtojnë tema specifike si tekstili, peshkataria, shkenca dhe teknologjia, transporti, etj. Marrëveshjet e këtyra i nënshtrohen miratimit të Parlamentit Evropian, në fushat ku ai ka fuqi bashkë-vendosëse.

5. MIRATIMI I BUXHETIT TË BE-SË

Buxheti vjetor i BE-së vendoset bashkarisht nga Këshilli dhe Parlamenti Evropian. Nëse dy institucionet nuk pajtohen, atëherë ndiqen procedurat e pajtimit deri sa të miratohet buxheti.

Ekzistojnë 10 konfiguracione të ndryshme të Këshillit:

Kryesuar nga Përfaqësuesi i Lartë për Punë të Jashtme dhe Politikë Sigurie:

► Punët e Jashtme

Kryesuar nga Shtetet Anëtare që mbajnë Presidencën e Këshillit:

► Çështjet e përgjithshme

► Çështjet e ekonomike dhe financiare

► Gjqësia dhe punët e brendshme

► Punësimi, politika sociale, shëndetësia dhe çështjet e konsumatorëve

► Konkurrenca (tregu i brendshëm, industria, hulumtimi dhe hapësira)

► Transporti, Telekomunikacioni dhe Energjia

► Bujqësia dhe Peshkataria

► Mjedis

► Arsimit, Rinia, Kultura dhe Sporti

Si funksionon Këshilli

Të gjitha diskutimet e Këshillit dhe votimi i akteve legislative bëhen publikisht. Mbledhjet e këtyra mund të ndiqen drejtpërsëdrejti në ueb faqen e Këshillit.

Stabiliteti i përgjithshëm në punën e konfiguracioneve të ndryshme të Këshillit sigurohet nga Këshilli për Çështje të Përgjithshme, i cili monitoron vazhdimësinë efektive të mbledhjeve të Këshillit Evropian. Atë e mbështet Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm ('Coreper' — nga frengjishtja: 'Comité des Représentants Permanents').

Coreper përbëhet nga Përfaqësues të Përhershëm të qeverive të Shteteve Anëtare në Bashkimin Evropian. Në Bruksel, çdo Shtet Anëtar i BE-së ka një ekip ('Përfaqësimit të Përhershëm') që e përfaqëson atë dhe i mbron interesat nacionale në nivel të BE-së. Kreu i çdo Përfaqësimi është në fakt, ambasador i vendit të vet në BE. Këta ambasadorë takohen një herë në javë në kuadër të Coreper-it.

Roli i Coreper-it është të përgatisë punën e Këshillit, me përjashtim të çështjeve bujqësore, të cilat i trajton Komiteti Special për Bujqësi. Coreper-in e ndihmojnë disa grupe punuese që përbëhen nga zyrtarë të administratave nacionale.

Sa vota për shtet?

Vendimet në Këshill merren me votim. Për momentin, Këshilli merr vendime duke votuar me mazhorancë të kualifikuar, me përjashtim të rasteve kur traktatet kërkojnë procedurë tjetër, p.sh. votim unanim në fushat e taksave dhe politikës së jashtme. Sipas votimit me mazhorancë të kualifikuar, sa më e madhe është popullata aq më i madh është numri i votave të Shtetit Anëtar, edhe pse ky sistem është përshtatur për të dhënë më shumë peshë proporcionalisht për vendet më pak të populluara.

Atëherë kur do të bashkohet Kroacia, në vitin 2013, do të ketë shtatë vota. Në vitin 2014, metoda aktuale e votimit me mazhorancë të kualifikuar do të zëvendësohet me një të re — votimin e mazhorancës së dyfishtë. Për të kaluar në Këshill, ligjet e propozuara të BE-së do të kenë nevojë për mazhorancën, jo vetëm të vendeve anëtare të BE-së (55 %) por edhe të popullatës së BE-së (65 %). Kjo do të pasqyrojë legjitimitetin e BE-së si union i popujve dhe kombeve. Do ta bëjë ligjvënien edhe më transparente edhe më efektive. Dhe, do të shoqërohet nga një mekanizëm ku së paku katër Shtete Anëtare që përfaqësojnë së paku 35% të popullatës së BE-së, mund të bllokojnë një vendim. Aty ku përdoret ky mekanizëm, Këshilli duhet të bëjë ç'mos për të arritur një zgjidhje të kënaqshme në suaza të një periudhe të arsyeshme kohore.

VOTAT NGA SHTETET NË KËSHILL	
Gjermania, Franca, Italia, Britania e Madhe	29
Spanja, Polonia	27
Rumania	14
Holanda	13
Belgjika, Republika Çeke, Greqia, Hungaria, Portugalia	12
Austria, Bullgaria, Suedia	10
Danimarka, Irlanda, Lituania, Sllovakia, Finlanda	7
Qiproja, Estonia, Letonia, Luksemburg, Sllovenia	4
Malta	3
Gjithsej	345
Numri i votave të nevojshme për mazhorancën e kualifikuar	255

Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit

Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit ndihmon Këshillin Evropian dhe Presidentin e tij, Këshillin dhe Presidentin e tij të rradhës. Atë e kryeson Sekretari i Përgjithshëm i emëruar nga Këshilli.

Çfarë është 'bashkëpunimi i zgjeruar'?

Nëse disa Shtete Anëtare duan të kenë bashkëpunim më të ngushtë në fushat e politikës që nuk janë kompetencë ekskluzive e BE-së, mirëpo nuk mund të arrijnë dakordimin e të gjitha Shteteve të tjera Anëtare, atëherë mekanizmi i quajtur 'bashkëpunimi i zgjeruar' u mundëson të punojnë së bashku. Ky mekanizëm lejon së paku nëntë Shtete Anëtare të shfrytëzojnë institucionet e BE-së, për të arritur bashkëpunim më të ngushtë. Mirëpo, ekzistojnë kushte: ky bashkëpunim duhet të çojë më tej synimin e Bashkimit Evropian dhe duhet të jetë i hapur për të gjitha Shtetet Anëtare, nëse kanë dëshirë të bashkohen.

Këtë procedurë e shfrytëzojnë disa vende për ligjin mbi divorcin, duke mundësuar gjetjen e zgjidhjes së përbashkët për çiftet që janë nga vende të ndryshme të BE-së, e të cilët duan të divorcohen në BE. Procedura vlen edhe për sistemin unitary të patentimit, i cili përfshin shumicën – por jo të gjitha Shtetet Anëtare.

Eurogrupi

Të gjitha Shtetet Anëtare bëjnë pjesë në Unionin Ekonomik dhe Monetar (EMU), që do të thotë se ata e koordinojnë politikë-bërjen e tyre ekonomike dhe i trajtojnë vendimet ekonomike si çështje e interesit të përbashkët. Mirëpo, nuk janë të gjitha Shtetet Anëtare pjesë e euro zonës dhe nuk e kanë pranuar të gjitha monedhën e vetme — euron. Disa kanë zgjedhur të bashkohen tani, kurse shtetet e tjera akoma janë duke përgatitur ekonomitë e tyre për të plotësuar kriteret e anëtarësimit në euro zonë. Shtetet Anëtare që janë pjesë e euro zonës duhet të bashkëpunojnë ngushtë. Ato i nënshtrohen politikës së vetme monetare, të cilën e drejton Banka Qendrore Evropiane. Prandaj, Shtetet Anëtare të euro zonës kanë nevojë për forum, në mënyrë që të diskutojnë dhe të vendosin mbi politikën e euro zonës. Ky nuk mund të jetë Këshilli për Çështje Ekonomike dhe Financiare (Ecofin) pasi që ky përbëhet nga të gjitha Shtetet Anëtare.

Zgjidhja është Eurogrupi, i cili përbëhet nga ministrat e ekonomisë dhe financave të anëtarëve të euro zonës.



© Associated Press / Reporters

Rregullat e reja të BE-së mbi qeverisjen ekonomike dhe financiare ndihmojnë në arritjen e profiteve dhe përforcimin e sektorit bankar.

Eurogrupi vepron për të promovuar zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin financiar në zonën e euros, me anë të koordinimit të politikave ekonomike. Pasi që vetëm Ecofin-i mund të marrë zyrtarisht vendime mbi çështje ekonomike, Eurogrupi mbledhet jozyrtarisht një ditë para mbledhjeve të Ecofin-it, afërsisht një herë në muaj. Ditën e ardhshme, marrëveshjet e arritura në takimim joformal të Eurogrup-it, vendosen formalisht në mbledhjen e Ecofin-it, nga anëtarët e Eurogrup-it. Vetëm ministrat e Ecofin-it, të cilët përfaqësojnë anëtarët e euro zonës, votojnë lidhur me çështje të Eurogrup-it. Në mbledhjet e Eurogrupit marrin pjesë Komisioneri për Çështje Ekonomike dhe Monetare dhe për Euro, dhe Presidenti i Bankës Qendrore Evropiane.


Anëtarët e Eurogrup-it zgjedhin President me mandat dy vjet e gjysmë. Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit siguron mbështetje administrative për mbledhjet e Eurogrup-it.

Politika e përbashkët e punëve të jashtme dhe e sigurisë

Bashkimi Evropian zhvillon në mënyrë progresive një politikë të përbashkët për punë të jashtme dhe siguri (CFSP), e cila u nënshtrohet procedurave të ndryshme në krahasim me fushat e politikave të tjera. CFSP definohet dhe implementohet nga puna e përbashkët e Këshillit Evropian dhe Këshillit. Objektivat më të gjera të Bashkimit Evropian janë avancimi i demokracisë, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe liria, respektimi i dinjitetit njerëzor dhe parimet e barazisë dhe solidaritetit. Për të arritur këto objektiva, BE-ja zhvillon marrëdhënie dhe partneritete me vendet dhe organizatat e tjera në mbarë botën.

Përgjegjësitë e CFSP janë si vijon:

- ▶ Këshilli Evropian, i kryesuar nga Presidenti, definon politikën e përbashkët për punë të jashtme dhe siguri, duke marrë parasysh interesat strategjikë të Unionit, duke përfshirë çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen.
- ▶ Këshilli, dhe sidomos Këshilli i Punëve të Jashtme, merr vendimet e nevojshme për të definuar dhe implementuar CFSP-në, duke ndjekur udhëzimet e Këshillit Evropian. Përfaqësuesi i Lartë për Punë të Jashtme dhe Politikë Sigurie kryeson mbledhjen e Këshillit të Punëve të Jashtme.
- ▶ Përfaqësuesi i Lartë, së bashku me Shtetet Anëtare vë në fuqi CFSP-në, duke garantuar vazhdimësinë dhe efektshmërinë e implementimit të saj. Për të bërë këtë, ai ose ajo mund të kërkojë shfrytëzimin e resurseve nacionale dhe atyre të Bashkimit Evropian.



Zbatuesit e ligjit në vendet e BE-së punojnë së bashku për të luftuar krimin ndërkombëtar.

© Matteis/ LookatSciences/Reporters

Shërbimi Evropian për Veprime të Jashtme (EEAS) shërben si ministri e jashtme dhe shërbim diplomatik i Bashkimit Evropian. Përfaqësuesi i Lartë është kreu i shërbimit, i cili përbëhet nga staf profesional i transferuar nga Këshilli, Shtetet Anëtare dhe nga Komisioni Evropian. BE-ja ka delegacione në shumicën e vendeve në mbarë botën dhe ato janë pjesë e EEA-së. Ato punojnë për së afërmi me çështje të CFSP-së, bashkë me ambasadat nacionale të Shteteve Anëtare të BE-së.

Çështjet me rëndësi për CFSP-në mund të parashtrihen në Këshill, nga cilido Shtet Anëtar ose nga Përfaqësuesi i Lartë që vepron vetëm ose së bashku me Komisionin. Duke marrë parasysh natyrën e shpeshtë urgjente të disa çështjeve të CFSP-së, ekzistojnë mekanizma që sigurojnë se vendimet mund të merren shpejtë. Në përgjithësi, vendimet në këtë fushë merren njëzëri.

Krahas avancimit të CFSP-së, Përfaqësuesi i Lartë gjithashtu përfaqëson politikën e jashtme dhe atë të sigurisë të Bashkimit Evropian në mbarë botën, duke realizuar dialog politik me vendet e treta dhe me vendet partnere, dhe duke shprehur qëndrimin e BE-së nëpër mbledhje dhe në organizata ndërkombëtare. Në nivel të Shefave të Shteteve dhe Qeverive, Bashkimi Evropian Përfaqësohet nga Presidenti i Këshillit Evropian.

Një aspekt i CFSP-së është siguria dhe çështjet e mbrojtjes, ku BE-ja zhvillon një politikë të përbashkët të

sigurisë dhe mbrojtjes (CSDP). Kjo politikë është e hartuar që t'u mundësojë vendeve të BE-së të ndërmarrin operacione për menaxhimin e krizës. Këto janë misione humanitare, paqebërëse ose paqeruajtëse, të cilat mund të jenë qoftë të natyrës ushtarake apo asaj civile. Gjatë operacioneve të këtyra, Shtetet Anëtare vullnetarisht vënë në dispozicion një pjesë të forcave të tyre për BE-në. Kjo gjithnjë është e koordinuar me NATO-n, strukturat komanduese të të cilës ndonjëherë përdoren për detyra praktike në misionet e BE-së. Këtë punë e koordinojnë një numër i madh i organeve permanente të BE-së.

- ▶ **Komiteti për Politikë dhe Siguri (PSC)** — monitoron situatën ndërkombëtare dhe shqyrton opsionet e BE-së për të reaguar në ndonjë situatë krize në botën e jashtme.
- ▶ **Komiteti Ushtarak i Bashkimit Evropian (EUMC)** — përbëhet nga kreu i mbrojtjes të çdo vendi të BE-së, drejton aktivitetet ushtarake të BE-së dhe ofron këshilla lidhur me çështje ushtarake.
- ▶ **Stafi Ushtarak i Bashkimit Evropian (EUMS)** — përbëhet nga ekspertë ushtarakë që punojnë në selinë e përhershme në Bruksel dhe i ndihmojnë EUMC-së.

Komisioni Evropian

Promovimi i interesit të përbashkët

Roli: Krahu ekzekutiv i BE-së që propozon ligje, marrëveshje politike dhe promovon Bashkimin Evropian

Anëtarë: Një kolegji i Komisionerëve, një nga çdo Shtet Anëtar

Vendi: Bruksel

▶ ec.europa.eu

Komisioni është institucion politikisht i pavaraur, i cili përfaqëson dhe përkrah interesat e BE-së në tërësi. Në shumë fusha, Komisioni është forca shtytëse përbrenda sistemit institucional të BE-së: propozon legjislacion, politika dhe programe për veprim dhe, është përgjegjës për implementimin e vendimeve të Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Ai gjithashtu përfaqëson Bashkimin Evropian në botën e jashtme, me përjashtim të politikës së përbashkët për punë të jashtme dhe siguri.

Çfarë është Komisioni?

Termi 'Komision' përdoret në dy aspekte. Së pari, i referohet 'Anëtarëve të Komisionit' — d.m.th. ekipi i meshkujve dhe femrave të emëruar nga Shtetet Anëtare dhe Parlamenti për të udhëhequr institucionin dhe për të marrë vendime. Së dyti, fjala 'Komision' i referohet vet institucionit dhe stafit të tij.

Joformalisht, Anëtarët e Komisionit quhen 'Komisionerë'. Të gjithë ata kanë qenë në pozita politike dhe shumica kanë qenë ministra të qeverive, mirëpo si anëtarë të Komisionit, ata janë të angazhuar për të vepruar në interesa të Bashkimit Evropian si tërësi dhe jo të marrin instrukcione nga qeveritë nacional.

Komisioni ka disa zëvendës Presidentë, një nga të cilët është edhe Përfaqësuesi i Lartë për Punë të Jashtme dhe Politikë Sigurie dhe kështu është prezent në të dyja kampet – edhe në Këshill edhe në Komision.

Komisioni mbetet politikisht përgjegjës para Parlamentit, i cili ka fuqinë ta shkarkojë me anë të miratimit të një shkresë të kundërshtimit. Komisioni merr pjesë në të gjitha seancat e Parlamentit, ku duhet të sqarojë dhe të justifikojë politikën e veta. Ai gjithashtu rregullisht iu përgjigjet pyetjeve me shkrim dhe me gojë, të parashtruara nga Deputetët e Parlamentit.



Zhoze Manuel Barroso udhëheq organin ekzekutiv të BE-së si President i Komisionit Evropian.

© EU

Emërimi i Komisionit

Një Komision i ri emërohet çdo pesë vjet, përbrenda gjashtë muajve të zgjedhjeve për Parlamentin Evropian. Procedura është si vijon:

- ▶ Qeveritë e Shteteve Anëtare propozojnë një President të ri të Komisionit, i cili duhet të zgjidhet nga Parlamenti Evropian.
- ▶ Presidenti i propozuar i Komisionit, në diskutim me qeveritë e Shteteve Anëtare, zgjedh anëtarët e tjerë të Komisionit.

Parlamenti i ri atëherë i interviston të gjithë anëtarët e propozuar dhe jep opinionin e vet lidhur me 'Kolegjin' e plotë. Nëse miratohet, Komisioni i ri, mund të fillojë zyrtarisht me punë në muajin janar.

Puna e përditshme e Komisionit kryhet nga zyrtarët e tij administrativë, ekspertët, përkthyesit, interpretuesit dhe stafi i sekretarisë. Zyrtarët e Komisionit — ashtu si stafi i organeve të tjera të BE-së — rekrutohen përmes Zydrës Evropiane për Selektim të Personelit (EPSO): europa.eu/epso. Ata janë qytetarë të çdo vendi të BE-së, të përzgjedhur sipas testimeve të hapura konkurruese. Ekzistojnë rreth 33 000 persona që punojnë për Komisionin. Ky numër mund të tingëllojë si shumë i madh, mirëpo në fakt është numër më i vogël se ai i të punësuarve në shumicën e këshilleve të qyteteve me madhësi të mesme në Evropë.

Çfarë bën Komisioni

Komisioni Evropian ka katër role kryesore:

1. Të propozojë legjislacion në Parlament dhe në Këshill;
2. Të menaxhojë dhe implementojë politikën dhe buxhetin e BE-së;
3. Të zbatojë ligjin evropian (së bashku me Gjykatën e Drejtësisë);
4. Të përfaqësojë Unionin në mbarë botën.

1. PROPOZIMI I LEGJISLACIONIT TË RI

Në suaza të Traktatit të BE-së, Komisioni ka të 'drejtën e iniciativës'. Me fjalë të tjera, Komisioni është përgjegjës për hartimin e propozimeve për legjislacionin e ri evropian, të cilin ia prezenton Parlamentit dhe Këshillit. Këto propozime duhet të synojnë për të mbrojtur interesat e Unionit dhe qytetarëve të tij, dhe jo ato të vendeve ose industrive të veçanta.

Para se të bëhen propozime, Komisioni duhet të jetë i vetëdijshëm për zhvillimin e situatave dhe problemeve të reja në Evropë dhe duhet të marrë parasysh nëse legjislacioni i BE-së është mënyra më e mirë për të trajtuar ato. Kjo është arsyeja që Komisioni është në kontakt të vazhdueshëm me një numër të madh të grupeve të interesit dhe me dy organe këshilldhënëse — Komiteti Ekonomik dhe Social (i përbërë nga përfaqësues të punëdhënësve dhe sindikatës) dhe Komiteti i Rajoneve (i përbërë nga përfaqësues të autoriteteve lokale dhe rajonale). Ai gjithashtu kërkon opinionet e parlamenteve nacionale, qeverive dhe publikut në përgjithësi.

Komisioni do të propozojë veprime në nivel të BE-së, vetëm nëse mendon se një problem nuk mund të zgjidhet në mënyrë më efektive me veprime nacionale, rajonale dhe lokale. Ky parim i trajtimit të çështjeve në nivelin më të ulët të mundshëm, quhet 'parimi i subsidiaritetit'.

Mirëpo, nëse Komisioni konkludon se është i nevojshëm legjislacioni i BE-së, atëherë harton një propozim për të cilin beson se do të mund të trajtojë problemin në mënyrë efektive dhe do të kënaq një numër të madh interesash. Në mënyrë që të ketë korrektësinë e vet teknike, Komisioni konsulton ekspertët që përbëjnë komitetet e tij të ndryshme dhe grupet e ekspertëve.

2. IMPLEMENTIMI I POLITIKAVE TË BE-SË DHE BUXHETI

Si organ ekzekutiv i Bashkimit Evropian, Komisioni është përgjegjës për menaxhimin dhe implementimin e buxhetit të BE-së dhe të politikave dhe programeve të miratuara nga Parlamenti dhe Këshilli. Pjesa më e madhe e punës dhe shpenzimit bëhet nga autoritetet nacionale dhe lokale mirëpo Komisioni është përgjegjës për mbikqyrjen e tij.

Komisioni trajton buxhetin nën syrin vigjilent të Gjykatës së Auditorëve. Të dy institucionet synojnë garantimin e menaxhimit të mirëfilltë financiar. Vetëm nëse është i kënaqur me raportet vjetore të Gjykatës së Auditorëve, Parlamenti Evropian i jep Komisionit dritën e gjelbër për të implementuar buxhetin.



© Langrock/Zemil/LaifReporters

Inovacioni dhe hulumtimi janë një nga mënyrat për të krijuar vende të reja pune dhe zhvillim në Evropë.

Ndërtimi i fushës kërkimore evropiane

Me anë të Drejtorisë Gjenerale për Hulumtim, Komisioni harton politikën e BE-së në fushën e hulumtimit dhe zhvillimit teknologjik dhe kontribuon për konkurrencën ndërkombëtare të industrisë së Evropës. Programi Kornizë për hulumtim dhe Zhvillim Teknologjik i Komisionit injektonte dhjetëra miliardë euro për hulumtimet multidisiplinare shkencore në mbarë BE-në dhe është kontribues kryesor për krijimin e fushës hulumtuese pa kufij në mbarë Evropën.

3. ZBATIMI I LIGJIT EVROPIAN

Komisioni vepron si '**gardian i traktateve**'. Kjo do të thotë se bashkë me Gjykatën e Drejtësisë, Komisioni është përgjegjës për të siguruar zbatimin e duhur të ligjit të BE-së në të gjitha Shtetet Anëtare. Nëse sheh se ndonjë vend i BE-së nuk zbaton ligjin e Bashkimit Evropian, dhe në këtë mënyrë nuk i përmbush obligimet e veta ligjore, Komisioni ndërmerr hapa për të përmirësuar situatën.

Së pari, ai fillon një proces ligjor të quajtur 'procedura e shkeljes'. Këtu përfshihet letra zyrtare që i dërgohet qeverisë, ku sqarohet se pse Komisioni beson që ky vend e shkel ligjin e BE-së, dhe i cakton një afat për t'i dërguar Komisionit një përgjigje të hollësishme. Nëse kjo procedurë nuk arrin të korrigjojë çështjet, Komisioni e referon këtë çështje në Gjykatën e Drejtësisë, e cila ka fuqinë për të vënë gjoba. Vendimet e Gjykatës janë detyruese për Shtetet Anëtare dhe për institucionet e BE-së.

4. PËRFAQËSIMI I BE-SË NË SKENËN NDËRKOMBËTARE

Përfaqësuesi i Lartë për Punë të Jashtme dhe Politikë Sigurie është Zëvendës President i Komisionit dhe mban përgjegjësinë për çështjet e jashtme. Në çështjet që kanë të bëjnë me punët e jashtme dhe sigurinë, Përfaqësuesi i Lartë punon me Këshillin. Mirëpo, në

fusha të tjera të veprimit të jashtëm, Komisioni luan rol udhëheqës — sidomos në fushat e politikës tregtare dhe ndihmës humanitare (shih kutinë më poshtë). Në këto fusha, Komisioni Evropian vepron si një zëdhënës me rëndësi për Bashkimin Evropian në skenën ndërkombëtare. Ai i ndihmon 27 Shtetet Anëtare të flasin njëzëri në forumet ndërkombëtare, siç është Organizata Botërore Tregtare.

Ndihma për ata që kanë nevojë

Departamenti i Ndhmës Humanitare dhe Mbrojtjes Civile i Komisionit Evropian (ECHO) u themelua në 1992. Aktivitetet humanitare tani përbëjnë pozitën kryesore të aktiviteteve të jashtme të Bashkimit Evropian — vërtetë, BE-ja është lojtar kryesor botëror në këtë fushë.

Rreth 150 milionë njerëz marrin ndihmë çdo vjet me anë të ndihmave humanitare të BE-së. Kjo ndihmë ndahet përmes 200 partnerëve, siç janë organizatat bamirëse dhe agjencitë e Kombeve të Bashkuara. Ndihma bazohet në parimet humanitare të mosdiskriminimit dhe paanësisë.



© EU

Kethrin Eshton është shefe e politikës së jashtme të BE-së dhe koordinon veprimet e BE-së në raport me pjesën tjetër të botës.

Si funksionon Komisioni

Nga vendimi i Presidentit të Komisionit varet se cili komisioner do të jetë përgjegjës për cilën fushë politike, dhe të riorganizojë këto përgjegjësi (nëse është e nevojshme) gjatë mandatit të Komisionit. Presidenti gjithashtu ka të drejtë të kërkojë dorëheqjen e një Komisioneri. Ekipi prej 27 Komisionerësh (gjithashtu i njohur si 'Kolegji') takohet një herë në javë, zakonisht ditëve të mërkura, në Bruksel. Secila pikë e agjendës prezantohet nga Komisioneri përgjegjës për atë fushë, dhe Kolegji merr vendim kolektiv për atë.

Stafi i Komisionit organizohet në dy departamente, të njohura si drejtori gjenerale (DG) dhe shërbime (siç janë Shërbimet Ligjore dhe Shërbimet e Përkthimit). Secila DG është përgjegjëse për një fushë të caktuar politike — për shembull, DG për Tregti dhe DG për Konkurrencë — dhe kryesohet nga Drejtori Gjeneral, i cili i përgjigjet njerit prej Komisionerëve.

Eurostat: grumbullimi i të dhënave të Evropës

Eurostat është Enti Statistikor i Bashkimit Evropian dhe pjesë e Komisionit. Detyra e tij është t'i sigurojë BE-së statistikat në nivel evropian, të cilat mundësojnë krahasimin me statistikat e vendeve dhe rajoneve të tjera. Kjo është një detyrë e rëndësishme. Shoqëritë demokratike nuk funksionojnë siç duhet, pa një bazë solide të statistikave të besueshme dhe objektive.

Statistika e Eurostatit mund të përgjigjë shumë pyetje: a është papunësia përpjetë apo tatëpjetë? A është emetimi i CO2 më i madh në krahasim me emetimin 10 vjet më parë? Cili është numri i femrave që shkojnë në punë? Si funksionon ekonomia e vendit tuaj në krahasim me atë të Shteteve të tjera Anëtare të BE-së?

► epp.eurostat.ec.europa.eu

Janë Drejtoritë Gjenerale që në fakt zhvillojnë dhe përpilojnë propozimet legislative të Komisionit, mirëpo këto propozime bëhen zyrtare vetëm kur 'miratohen' nga Kolegji në mbledhjen e vet javore. Procedura është afërsisht si sqarimi në vijim.

Supozoni, për shembull, se Komisioni sheh nevojën për legjislacion të BE-së, për parandalimin e ndotjes së lumenjve të Evropës. Drejtorja Gjenerale për Mjedis do të përpilojë një propozim, në bazë të konsultimeve të përgjithshme me industrinë dhe bujqit e Evropës, me ministritë e mjedisit në Shtetet Anëtare dhe me organizatat e mjedisit. Shumë propozime janë të hapura për konsultime publike, duke u dhënë mundësi individëve të japin mendime në kapacitet personal ose në emër të një organizate.

Legjislacioni i propozuar atëherë diskutohet me të gjitha departamentet relevante të Komisionit dhe ndryshohet nëse ka nevojë. Pastaj kontrollohet nga Shërbimi Ligjor.

Pasi kompletimit të propozimit, Sekretari Gjeneral do të përfshijë atë në agjendën për mbledhjen e ardhshme të Komisionit. Në këtë mbledhje, Komisioneri për Mjedis do t'u sqarojë kolegëve të vet se pse propozohet legjislacioni, dhe pastaj e diskuton atë. Nëse ekziston marrëveshje, kolexhi do të miratojë propozimin dhe dokumenti do të dërgohet në Këshill dhe në Parlamentin Evropian për shqyrtim.

Mirëpo, nëse ekziston mosmarrëveshje midis Komisionerëve, Presidenti mund të kërkojë që ta votojnë atë. Nëse shumica janë në favor, propozimi miratohet. Pas kësaj, ajo do të ketë mbështetjen e të gjithë anëtarëve të Komisionit.

Parlamentet nacionale

Zbatimi i subvencionimit

Roli: Të marrë pjesë së bashku me institucionet evropiane në punën e Unionit
Anëtarë: Deputetët e parlamenteve nacionale
Vendi: Të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së

Institucionet e BE-së inkurajojnë parlamentet nacionale të involvohen më tepër në aktivitetet e Bashkimit Evropian. Nga viti 2006, Komisioni ka transmetuar të gjitha propozimet e reja legislative në parlamentet nacionale, dhe u është përgjigjur opinioneve të tyre. Me Traktatin e Lisbonës nga viti 2009, të drejtat dhe detyrat e parlamenteve nacionale përbrenda BE-së janë përcaktuar qartë. Parlamentet nacionale tani kanë mundësi që më mirë të shprehin pikëpamjet e tyre mbi projekt-aktet legislative si dhe për çështje të tjera që mund të kenë domethënie të veçantë për ata.

Risi e madhe është fuqia e re për të zbatuar subsidiaritetin. Veprimet e BE-së i nënshtrohen parimit të subsidiaritetit. Kjo do të thotë se Unioni vepron vetëm në rastet kur veprimi do të jetë më efektiv në nivel të BE-së se në nivel nacional. Kështu do të ndodhë në rastet ku traktatet i kanë dhënë BE-së kompetenca ekskluzive, përndryshe është një vendim që merret veçantë për çdo ligj të ri. Zbatimi i drejtë i këtij parimi në vendim-marrjen e BE-së monitorohet nga parlamentet nacionale.

Për të mundësuar që parlamentet të kryejnë kontrollet e subsidiaritetit, Komisioni i dërgon projekt-ligjet në parlamentet nacionale, në të njëjtën kohë kur ia dërgon edhe ligjvënësit të Unionit (d.m.th. Parlamentit Evropian dhe Këshillit).

Çdo parlament nacional pastaj mund të japë një opinion të arsyetuar nëse mendon se propozimi në fjalë nuk përputhet me parimin e subsidiaritetit. Varësisht nga numri i opinioneve të arsyetuara të nxjerra nga parlamentet nacionale, Komisioni mund të duhet të ri-shqyrtojë propozimin e vet dhe të vendosë nëse do të mbajë, do ta përshtasë ose do ta tërheqë atë. Kjo është quajtur procedura e kartës së verdhë dhe portokalle. Në rastin e procedurës së zakonshme legislative, në qoftë se shumica e parlamenteve nacionale japin një opinion të arsyetuar, dhe me kusht që Komisioni të mbajë propozimin e vet, ai do të duhet të sqarojë arsyet e veta, kurse Parlamenti Evropian dhe Këshilli do të vendosin nëse do të vazhdojnë apo jo procedurën legislative.

Parlamentet nacionale janë gjithashtu të përfshira drejtpërdrejt me zbatimin e legjislacionit të BE-së. Direktivat e BE-së u adresohen autoriteteve nacionale, të cilat duhet të marrin masa për t'i bërë ato pjesë të ligjit nacional. Direktivat përcaktojnë rezultate përfundimtare që duhet të arrihen në çdo Shtet Anëtar, në datën e caktuar. Autoritetet nacionale duhet t'i përshtasin ligjet e tyre për të arritur këto qëllime, mirëpo janë të lirë të vendosin se si do ta bëjnë këtë. Direktivat përdoren për të harmonizuar ligjet e ndryshme nacionale me njëri-tjetrin, dhe janë veçanërisht të zakonshme në çështjet që ndikojnë në funksionimin e tregut të vetëm (p.sh. standardet e sigurisë së produktit).

Gjykata e Drejtësisë

Respektimi i ligjit të BE-së

Roli:	Të japë vendime ligjore për rastet që dalin para saj
Gjykata e Drejtësisë:	Një gjykatës nga çdo vend i BE-së; tetë Avokatë të Përgjithshëm
Gjykata e Përgjithshme:	Një gjykatës nga çdo vend i BE-së
Tribunali i Shërbimit Civil:	Shtatë gjykatës
Vendi:	Luxembourg
► curia.europa.eu	

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (Gjykata) siguron interpretimin dhe zbatimin e njëtrajtshëm të legjislacionit të BE-së në të gjitha Shtetet Anëtare. Me fjalë të tjera, siguron se ky legjislacion është gjithmonë i njëjtë për të gjitha palët dhe në të gjitha rrethanat. Për këtë qëllim, Gjykata kontrollon ligjshmërinë e veprimeve të institucioneve të BE-së, siguron se Shtetet Anëtare respektojnë detyrimet e tyre, dhe interpreton ligjin e BE-së me kërkesën e gjykatave nacionale.

Gjykata ka fuqinë për të zgjedhur mosmarrëveshjet ligjore mes Shteteve Anëtare, institucioneve të BE-së, bizneseve dhe midis individëve. Për të përballuar me mijëra raste që i pranon, ajo është e ndarë në dy organe kryesore: Gjykata e Drejtësisë, e cila trajton kërkesat për vendimet paraprake të gjykatave nacionale, veprime të caktuara për anulim dhe apel, dhe Gjykata e Përgjithshme, e cila vendos mbi të gjitha veprimet e anulimit, të paraqitura nga individë dhe kompani dhe disa veprime të ngjashme të paraqitura nga Shtetet Anëtare.

Një tribunal i specializuar, Tribunali i Shërbimit Civil, gjithashtu gjykon kontestet midis BE-së dhe nëpunësve civilë

Çfarë bën BE-ja

Gjykata jep vendime në rastet që sillen para saj. Katër lloje më të zakonshme të rasteve janë:

1. VENDIMI PARAPRAK

Gjykatat në çdo Shtet Anëtar të BE-së kanë përgjegjësinë për të siguruar zbatimin e duhur të ligjit të BE-së në atë vend. Nëse një gjykatë nacionale ka ndonjë dyshim mbi interpretimin ose vlefshmërinë e ndonjë ligji të BE-së, ajo ndonjëherë duhet të kërkojë këshillë nga Gjykata e Drejtësisë. Kjo këshillë jepet në formë të 'aktvendimit paraprak' detyrues. Ky vendim është një kanal i rëndësishëm që qytetarët, përmes gjykatave të tyre nacionale, të kuptojnë se sa shumë ndikojnë ligjet e BE-së tek ata.

Stjuardesat kanë përfutur disa herë nga vendimet e Gjykatës së Drejtësisë të BE-së mbi pagesën e barabartë dhe të drejtat e barabarta.



2. PROCEDURAT E SHKELJES

Komisioni ose (në disa raste të rralla) një Shtet Anëtar, mund të inicojë këto procedura nëse ka arsye të besojë se një Shtet Anëtar i caktuar po dështon të përmbushë detyrimet e veta sipas ligjit të BE-së. Gjykata heton akuzat dhe jep vendimin e vet. Nëse konkludohet se është fajtor, Shteti i akuzuar Anëtar duhet të përmirësojë gabimet pa vonesë, në mënyrë që t'u shmangët gjobave që mund t'i zbatojë Gjykata.

3. PROCEDURAT E ANULIMIT

Nëse ndonjë prej Shteteve Anëtare, Këshilli, Komisioni ose (në kushte të caktuara) Parlamenti, beson se një ligj i caktuar i BE-së është i paligjshëm, mund t'i kërkojnë Gjykatës që ta anulojë atë. Këto 'procedura për anulim' mund të shfrytëzohen edhe nga individët të cilët duan që Gjykata të anulojë një ligj të caktuar, sepse ndikon direkt dhe negativisht mbi ata si individë.

4. PROCEDURAT PËR DËSHTIM TË VEPRIMIT

Traktati kërkon që Parlamenti Evropian, Këshilli dhe Komisioni të marrin disa vendime në rrethana të caktuara. Nëse ata nuk e bëjnë këtë, Shtetet Anëtare, institucione të tjera të BE-së dhe (në kushte të caktuara) individët ose kompanitë, mund të paraqesin ankesë në Gjykatë, në mënyrë që të regjistrojnë zyrtarisht këtë shkelje.

Si funksionon Gjykata

Gjykata e Drejtësisë përbëhet nga 27 Gjykatës, një nga çdo Shtet Anëtar, në mënyrë që të përfaqësohen të gjitha sistemet ligjore nacionale të BE-së. Gjykata ndihmohet nga tetë 'Avokatë të Përgjithshëm' të cilët prezantojnë opinione të arsyetuara lidhur me rastet e paraqitura në Gjykatë. Ata duhet ta bëjnë këtë në mënyrë publike dhe të paanshme. Gjykatësit dhe Avokatët e Përgjithshëm janë ose ish-anëtarë të gjykatave të larta nacionale, ose avokatë mjaft kompetentë, të cilëve mund t'u besohet në aspektin e paanshmërisë. Ata emërohen me marrëveshje të përbashkët të qeverive të Shteteve Anëtare. Secili emërohet për një mandat të fiksuar prej gjashtë vjetësh. Gjykatësit e zgjedhin Presidentin i cili shërben tre vjet. Gjykata e Drejtësisë mund të punojë si Gjykatë e plotë, Dhoma e Madhe me 13 Gjykatës, ose Dhoma me nga pesë ose tre Gjykatës, varësisht nga

kompleksiteti dhe rëndësia e rastit. Gati 60 % të rasteve dëgjohej në Dhomat me pesë gjykatës dhe rreth 25 % nga Dhomat me tre Gjykatës.

Gjykata e Përgjithshme gjithashtu përbëhet nga 27 Gjykatës, të emëruar nga Shtete Anëtare me mandat gjashtë vjeçar. Gjykatësit e Gjykatës së Përgjithshme gjithashtu e zgjedhin Presidentin mes tyre për një mandat tre vjeçar. Kjo Gjykatë ulet në Dhomat me tre ose pesë gjykatës (ndonjëherë edhe një Gjykatës i vetëm) për të mbajtur dëgjimet. Rreth 80 % të rasteve në Gjykatën e Përgjithshme dëgjohej nga tre Gjykatës. Dhoma e Madhe me 13 Gjykatës, ose Dhoma e plotë me 27, mund të ulet nëse justifikohet ndërlikueshmëria ose rëndësia e rastit.

Të gjitha rastet dorëzohen në Zyrën e Regjistrimit në Gjykatë dhe atëherë emërohet një Gjykatës i veçantë dhe një Avokat i Përgjithshëm. Pas dorëzimit, ka dy hapa: hapi i parë është faza me shkrim e pastaj faza me gojë. Në fazën e parë, të gjitha palët e involvuara dorëzojnë deklaratat me shkrim dhe Gjykatësi i caktuar për rastin harton një raport në të cilin përmbledh këto deklaratat dhe informatat e rëndësishme mbi rastin. Ky raport diskutohet në Mbledhjen e Gjykatës së Përgjithshme, e cila vendos se cili formacion gjyqësor do të dëgjojë rastin dhe nëse janë të nevojshme argumentet gojore. Pastaj vjen faza e dytë — dëgjimi publik — ku avokatët vënë rastin e tyre para Gjykatësve dhe Avokatit të Përgjithshëm, të cilët mund t'i marrin në pyetje. Pas seancës gojore, Avokati i Përgjithshëm i caktuar për rastin harton opinionin e tij apo të saj. Lidhur me këtë opinion, Gjykatësi harton një projekt vendim i cili u dorëzohet Gjykatësve të tjerë për shqyrtim. Gjykatësit diskutojnë dhe japin vendimin e tyre. Vendimet e Gjykatës i merr shumica dhe ato shpallen në seancë publike. Në të shumtën e rasteve, teksti është në dispozicion në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së në të njëjtën ditë. Mendimet kundërshtuese nuk shprehen.

Këtë procedurë standarde nuk e ndjekin të gjitha rastet. Kur një rast kërkon trajtim urgjent, ekzistojnë procedura të thjeshtësuara dhe të përshpejtuara, të cilat lejojnë Gjykatën të marrë vendim në një periudhë afro tre mujore.

Banka Qendrore Evropiane

Sigurimi i stabilitetit të çmimeve

Roli: Të menaxhojë euron dhe politikën monetare të euro zonës

Anëtarë: Bankat qendrore nacionale të euro zonës

Vendi: Frankfurt am Main, Gjermani

► www.ecb.europa.eu

Mario Draghi është President
i Bankës Qendrore
Evropiane që nga viti 2011



© ImageGlobe

Qëllimi i Bankës Qendrore Evropiane (BQE) është të ruajë stabilitetin monetar në euro zonë, duke siguruar inflacion të ulët dhe stabil të çmimeve të konsumatorit. Inflacioni i ulët dhe stabil i çmimeve konsiderohet vital për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, pasi që ky inkurajon ndërmarrjet të investojnë dhe të krijojnë më shumë vende pune — dhe kështu shtojnë standardin jetësor të evropianëve. BQE është një institucion i pavarur që i merr vendimet e veta pa kërkuar ose pa marrë instruksione nga qeveritë ose institucionet e tjera të BE-së.

Çfarë bën Banka Qendrore Evropiane

Banka Qendrore Evropiane u themelua në vitin 1998, kur u prezantua valuta euro, për të menaxhuar politikën monetare në euro zonë. Synimi kryesor i BQE-së është të ruajë stabilitetin e çmimeve. Kjo definohet si përqindje e inflacionit të çmimit të konsumatorit, më të vogël se, por deri në rreth 2 % në vjet. BQE-ja gjithashtu ndërmerr aktivitete për të mbështetur punësimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Bashkimin Evropian.

Si BQE-ja menaxhon stabilitetin e çmimeve

BQE-ja përcakton përqindjen e kamatave për huazim në bankat komerciale, gjë që ndikon në çmimin dhe sasinë e parave në ekonomi — dhe në këtë mënyrë, ndikon edhe në përqindjen e inflacionit. Për shembull, atëherë kur paraja është në furnizim të bollshëm, përqindja e inflacionit të çmimit të konsumatorit mund të rritet, dhe kështu shtrenjton mallërat dhe shërbimet. Si reagim ndaj kësaj, BQE-ja mund të shtojë koston e huasë, me rritjen e përqindjes së kamatës në huatë që ua jep bankave komerciale — dhe me këtë zvogëlohet furnizimi i parave, gjë që zvogëlon presionin mbi çmimet. E njëjta ndodh edhe nëse ka nevojë për stimulim të aktiviteteve ekonomike — atëherë BQE-ja mund të zvogëlojë përqindjen e kamatave për të inkurajuar huamarrjen dhe investimin.

Për të kryer operacionet e veta kredituese, BQE-ja mban dhe administron rezervat zyrtare të huaja të anëtarëve të euro zonës. Detyrat e tjera përfshijnë kryerjen e operacioneve të këmbimit valutor, promovimin e sistemeve efikase të pagesës në mbështetje të tregut të vetëm, miratimin e prodhimit të kartmonedhave euro nga anëtarët e euro zonës, si dhe grumbullimin e të dhënave relevante statistikore nga bankat qendrore nacionale. Presidenti i Bankës Qendrore Evropiane përfaqëson bankën në mbledhje të nivelit të lartë ndërkombëtar dhe në BE.

Si funksionon BQE-ja

Banka Qendrore Evropiane është institucion i Unionit Ekonomik dhe Monetar (EMU) të cilit i përkasin të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së. Bashkimi në euro zonë dhe pranimi i monedhës së vetme — euros — është faza përfundimtare e EMU-së. Nuk janë të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së pjesëtare të euro zonës: disa janë duke i përgatitur ekonomitë e tyre për t'u bashkuar, kurse të tjerë kanë zgjedhur të mos marrin pjesë. BQE-ja qëndron në thelbin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore e cila bashkon BQE-në dhe bankat qendrore nacionale të të gjitha Shteteve Anëtare të BE-së. Organizimi i BQE-së pasqyron këtë situatë në tre grupimet e veta kryesore:

► Këshilli i Përgjithshëm i Sistemit Evropian të Bankave Qendrore përbëhet nga guvernatorët e 27 bankave qendrore nacionale, së bashku me Presidentin dhe zëvendës presidentin e BQE-së.

► Bordi Ekzekutiv i BQE-së përbëhet nga Presidenti, Zëvendës Presidenti dhe katër anëtarë të tjerë — të gjithë të emëruar nga Këshilli Evropian, të cilët veprojnë me mazhorancë të kualifikuar, me funksion tetë vjeçar. Bordi Ekzekutiv është përgjegjës për zbatimin e politikës monetare, operacionet e përditshme të bankës, përgatitjen e mbledhjeve të Këshillit Drejtues si dhe ushtrimin e fuqive të caktuara, të deleguara nga Këshilli Drejtues.


► Këshilli Drejtues i BQE-së përbëhet nga gjashtë anëtarë të Bordit Ekzekutiv të BQE-së dhe Guvernatorët e bankave qendrore nacionale të 17 anëtarëve të euro zonës: së bashku ata formojnë Eurosistemin. Këshilli Drejtues është organi kryesor i BQE-së që merr vendime dhe takohet dy herë në muaj. Është rregull që, në mbledhjen e vet të parë çdo muaj, Këshilli Drejtues të vlerësojë zhvillimet ekonomike dhe monetare dhe i merr vendimet e veta mujore lidhur me politikën monetare. Në mbledhjen e vet të dytë, Këshilli kryesisht diskuton çështje që kanë të bëjnë me detyra dhe përgjegjësi të tjera të BQE-së.

EU Member States using the euro as of 2012

AT: Austria	ES: Spanja	MT: Malta
BE: Belgjika	FI: Finlanda	NL: Holanda
CY: Qiproja	FR: Franca	PT: Portugalia
DE: Gjermania	IE: Irlanda	SI: Sllovenia
EE: Estonia	IT: Italia	SK: Sllovakia
EL: Greqia	LU: Luksemburgu	

EU Member States not using the euro

BG: Bullgaria	LT: Lituania	SE: Suedia
CZ: Republika Çeke	LV: Letonia	UK: Britania e Madhe
DK: Danimarka	PL: Polonia	
HU: Hungaria	RO: Rumania	



Qeverisja ekonomike: Kush çfarë bën?

Unioni Ekonomik dhe Monetar (EMU) është element thelbësor i integritetit evropian dhe të gjitha Shtete Anëtare të BE-së janë pjesë e tij. Politika fiskale (taksat dhe shpenzimet) mbetet në duart e qeverive individuale nacionale, ashtu si mbeten edhe politikat e punës dhe mirëqenies. Megjithatë, koordinimi i financave të shëndosha publike dhe politikave strukturore është çështje jetike për funksionimin efektiv të Unionit Ekonomik dhe Monetar. Përgjegjësitë janë të ndara midis Shteteve Anëtare dhe institucioneve të BE-së, si vijon:

- ▶ **Këshilli Evropian** përcakton orientimet kryesore të politikës.
- ▶ **Këshilli** koordinon politikëbërjen ekonomike të BE-së dhe merr vendimet që mund jenë detyruese për disa vende të BE-së.
- ▶ **Vendet e BE-së** caktojnë buxhetet e tyre nacionale në suaza të kufirit të dakorduar të deficitit dhe borxhit, dhe caktojnë politikat e veta strukturore ku përfshihen puna, pensionet, mirëqenia dhe tregjet.
- ▶ **Vendet e zonës së euros** koordinojnë politikat e interesit të përbashkët për zonën e euros në nivel të krerëve të shteteve dhe qeverive në 'Euro samit' dhe në nivel të ministrave të financave në 'Eurogrup'.
- ▶ **Banka Qendrore Evropiane** vendos politikën monetare për zonën e euros dhe objektivi kryesor e ka stabilitetin e çmimeve.
- ▶ **Komisioni Evropian** monitoron se çfarë janë duke bërë Shtetet Anëtare të BE-së dhe nxjerr rekomandime për politikat.
- ▶ **Parlamenti Evropian** formulon legjislacionin së bashku me Këshillin dhe ushtron kontroll demokratik të procesit të qeverisjes ekonomike.

Gjykata Evropiane e Auditorëve

Ndihma për të përmirësuar menaxhimin financiar të BE-së

Roli: Të kontrollojë grumbullimin dhe përdorimin e drejtë të fondeve të BE-së, dhe të përmirësojë menaxhimin financiar të BE-së

Anëtarë: Një nga çdo vend i BE-së

Vendi: Luksemburg

▶ eca.europa.eu

Gjykata Evropiane e Auditorëve (ECA) është institucion i pavarur i Bashkimit Evropian për revizion të jashtëm. Ky institucion kontrollon nëse të ardhurat e Unionit janë pranuar në mënyrë të rregullt, se shpenzimet e tij janë bërë në mënyrë ligjore dhe të rregullt, dhe se menaxhimi financiar ka qënë i shëndoshë. Gjykata kryen detyrat e saj pavarësisht nga institucionet e tjera të BE-së the pavarësisht nga qeveritë. Duke bërë këtë, ajo kontribuon në përmirësimin e menaxhimit të fondeve të Bashkimit Evropian, në interes të qytetarëve të vet.

Çfarë bën Gjykata Evropiane e Auditorëve

Roli kryesor i Gjykatës Evropiane të Auditorëve është të kontrollojë implementimin e drejtë të buxhetit të BE-së — me fjalë të tjera, kontrollon nëse të ardhurat e BE-së janë të ligjshme dhe të rregullta dhe se menaxhimi financiar është i shëndoshë. Kjo punë ndihmon për të siguruar se BE-ja menaxhohet në mënyrë efikase. Për të kryer detyrat e veta, ECA bën revizionin e detajuar të të ardhurave ose shpenzimeve të BE-së në të gjitha nivelet e administrimit të fondeve të BE-së. Ajo kryen kontrollet në

vet organizatat që menaxhojnë fondet ose te organizatat që i përfitojnë ato fonde, qoftë në Shtetet Anëtare të BE-së, qoftë në vende të tjera. Përfundimet e kësaj Gjykate botohen në raporte vjetore dhe specifike, të cilat e tërheqin vëmendjen e Komisionit dhe Shteteve Anëtare në raste të gabimeve dhe dobësive. Ajo gjithashtu jep rekomandimet për përmirësim.

Një funksion tjetër kryesor i Gjykatës Evropiane të Auditorëve është t'u ndihmojë autoriteteve buxhetore (Parlamentit Evropian dhe Këshillit) duke iu ofruar atyre një raport vjetor mbi implementimin e buxhetit të BE-së për vitin paraprak financiar. Konkluzat e Gjykatës Evropiane të Auditorëve në këtë raport, luajnë rol të rëndësishëm në vendimin shkarkues të Parlamentit për trajtimin e buxhetit nga ana e komisionit.

Gjykata Evropiane e Auditorëve jep edhe opinionin e vet lidhur me rregulloret e reja ose të rishikuara të BE-së me ndikim financiar, me kërkesë të institucioneve të tjera të BE-së. ECA mund të nxjerrë edhe dokumente që prezantojnë qëndrimin dhe tendencat e saj lidhur me çështje të tjera, me iniciativën e vet.



Etiketat e veshit të lopët u ndihmojnë auditorëve të BE-së të mbajnë evidencë se ku janë shpenzuar paratë e BE-së

Si funksionon Gjykata Evropiane e Auditorëve

Gjykata Evropiane e Auditorëve funksionon si një organ kolegjal me 27 Anëtarë, nga një prej çdo vendi të BE-së. Anëtarët i emëron Këshilli, pas konsultimit me Parlamentin Evropian, me mandat gjashtë vjeçar me mundësi për rizgjedhje. Ata zgjidhen për kompetencën dhe pavarësinë e tyre dhe punojnë për ECA-na me orar të plotë. Këta anëtarë zgjedhin njërin prej tyre për President, me mandat tre vjeçar.

Për të qënë efektive, Gjykata e Auditorëve — si çdo institucion tjetër suprem për revizion — duhet të mbetet e pavarur nga institucionet dhe organet të cilave u bën revizion. ECA mund të: zgjedhë temat për revizion, fushëveprimin specifik dhe qëndrimin që do të ndjekë; të vendosë si dhe kur të prezantojë rezultatet e revizioneve të zgjedhura; dhe të zgjedhë publicitetin që i duhet dhënë raporteve dhe opinionëve të saj. Këto janë elemente të rëndësishme të pavarësisë.

Gjykata Evropiane e Auditorëve ndahet në oda, të cilat përgatisin raportet dhe opinionet që duhet të miratojë ECA. Odat kane mbështetjen e stafit me kualifikime të

larta nga të gjitha Shtetet Anëtare. Auditorët shpesh bëjnë revizion në institucionet e tjera të BE-së, Shtetet Anëtare dhe në vendet e tjera përfituese. ECA gjithashtu bashkëpunon ngushtë me institucionet supreme të revizionit në Shtetet Anëtare. Vërtetë, edhe pse puna e ECA-s ka të bëjë shumë me buxhetin e BE-së — për të cilin Komisioni mban përgjegjësinë e përgjithshme — në praktikë, menaxhimi i më se 80 % të shpenzimeve ndahet me autoritetet nacionale.

Gjykata Evropiane e Auditorëve nuk ka fuqi gjyqësore mirëpo gjatë punës së vet, të gjitha çrregullsitë, dobësitë dhe rastet e dyshimta të mashtrimit i paraqet para organeve përgjegjëse të BE-së për këtë lloj aktiviteti, duke përfshirë edhe Zyrën Evropiane kundër mashtrimit (OLAF). Që nga themelimi i saj në vitin 1977, Gjykata Evropiane e Auditorëve ka ndikuar jashtëzakonisht shumë në menaxhimin financiar të buxhetit të BE-së, me anë të raporteve dhe opinionëve të veta objektive. Duke bërë këtë, ajo ka plotësuar rolin e vet të gardianit të pavarur të interesave financiare të qytetarëve të Bashkimit Evropian.

Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian

Zëri i shoqërisë civile

Roli: Të përfaqësojë shoqërinë e organizuar civile

Anëtarë: 344 nga të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së

Vendi: Bruksel

► eesc.europa.eu

Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian (KESE) është një organ këshillues i Bashkimit Evropian. Ai përbëhet nga përfaqësues të organizatave të punëdhënësve, të punësuarve dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile, sidomos në fushën socio-ekonomike, qytetare, profesionale dhe kulturore. Me përfaqësimin e interesave të përgjithshëm, Komiteti i dorëzon opinionet Komisionit, Këshillit dhe Parlamentit Evropian. Anëtarët e KESE-s nuk janë të lidhur me ndonjë udhëzim të detyrueshëm dhe ata punojnë për interesin e përgjithshëm të BE-së. Prandaj, KESE shërben si urë midis institucioneve të lartpërmendura të BE-së dhe qytetarëve të BE-së, duke promovuar një shoqëri më pjesëmarrëse, më përfshirëse dhe rrjedhimisht më demokratike në Bashkimin Evropian.

Çfarë bën KESE

Ky Komitet plotëson tre misione kryesore:

- ndihmon për të siguruar se politikat dhe legjislacioni evropian lidhen më mirë me rrethanat ekonomike, sociale dhe qytetarë në terren, duke ndihmuar Parlamentin Evropian, Këshillin dhe Komisionin Evropian, duke shfrytëzuar përvojën dhe përfaqësimin e anëtarëve të KESE-s, dialogun dhe përpjekjet për të siguruar konsensusin që u shërben interesave të përbashkëta;
- promovon zhvillimin e një Bashkimi Evropian më pjesëmarrës, i cili është më shumë në kontakt me mendimin popullor, duke vepruar si një forum institucional që përfaqëson, informon, shpreh qëndrimet e veta dhe siguron dialogun me shoqërinë e organizuar civile;
- promovon vlerat mbi të cilat është themeluar integrimi evropian dhe avancon kauzën e demokracisë dhe demokracisë pjesëmarrëse, si dhe rolin e organizatave të shoqërisë civile në Evropë dhe në mbarë botën.

Komiteti duhet të konsultohet me Parlamentin Evropian, Këshillin ose me Komisionin, në shumë fusha të parashikuara nga traktatet. Këto fusha janë zgjeruar në mënyrë progresive, kështu që fushëveprimi i KESE-s është zgjeruar edhe më tej. Përveç konsultimeve të obligueshme, Komiteti mund të nxjerrë opinionet me iniciativën e vet, në rastet kur beson se një veprim i tillë është me rëndësi për të mbrojtur interesat e shoqërisë civile. KESE ofron rreth 170 opinionet në vjet, nga të cilat afro 15 % janë me vet iniciativën e tij.

Një karakteristikë kryesore e punës së KESE-s është stimuli për ndërtimin e konsensusit midis anëtarëve të vet, të cilët përfaqësojnë një numër të madh të grupeve të interesit — për shembull, midis anëtarëve të grupeve të punëdhënësve dhe atyre që përfaqësojnë organizatat e punëtorëve. Komiteti është i pozicionuar mirë për të këshilluar mbi ndikimin e ligjeve të propozuara në terren — në jetën e njerëzve — dhe mbi mënyrën se si mund të përshtatet legjislacioni për të fituar mbështetjen e gjerë të publikut. Rritja e transparencës në vendim-marrjen e BE-së dhe ndërtimi i lidhjeve të ngushta me organizatat nacionale të shoqërisë civile, janë gjithashtu elemente me rëndësi për punën e Komitetit.

Si funksionon KESE

344 anëtarët e KESE-së nominohen me mandat pesë vjeçar nga qeveritë e tyre dhe emërohen nga Këshilli i Bashkimit Evropian. Anëtarët merren nga grupet e ndryshme evropiane të interesit ekonomik dhe social dhe pas emërimit, ata punojnë të pavarur nga qeveritë e tyre. Anëtarët e Komitetit organizohen në tre grupe të brendshme: punëdhënësit, të punësuarit dhe interesat e tjera. KESE zgjedh Presidentin e vet dhe dy Zëvendës Presidentë me mandate dy vjet e gjysmë. Anëtarët e KESE-s takohen nëntë herë në vjet në seancat plenare në Bruksel, ku opinionet miratohen me votimin e mazhorancës së thjeshtë.



Planifikimi i furnizimit me energji është një shqetësim për të gjithë evropianët – por edhe për orgnizatet e shoqërisë civile në Komitetin Ekonomik dhe Social

Përgatitja për këto seanca plenare bëhet nga gjashtë njësi tematike të kryesuara nga anëtarë të Komitetit dhe të mbështetura nga Sekretariati Gjeneral i Komitetit me seli në Bruksel. Njësitë tematike dhe komisionet janë:

- ▶ Njësia për union ekonomik dhe monetar dhe kohezion ekonomik dhe social (ECO);
- ▶ Njësia për tregun e vetëm, prodhimi dhe konsumi (INT);
- ▶ Njësia për transport, energji, infrastrukturë dhe shoqëri informative (TEN);
- ▶ Njësia për punësim, çështje sociale dhe shtetësi (SOC);
- ▶ Njësia për bujqësi, zhvillim rural dhe mjedis (NAT);
- ▶ Njësia për marrëdhënie të jashtme (REX);
- ▶ Komiteti Konsultativ mbi Ndryshimet Industriale (CCMI).

KESE ndjek progresin e strategjive afatgjata të BE-së me anë të të ashtuquajturve observatorë dhe me anë të një Bordi drejtues që monitoron implementimin e tyre dhe ndikon në nivelin bazë. Këto entitete janë si vijon:

- ▶ Observatori i zhvillimit të qëndrueshëm;
- ▶ Observatori i tregut të punës;
- ▶ Observatori i i Tregut të Vetëm;
- ▶ Bordi Drejtues Evropa 2020.

Marrëdhëniet me këshillet ekonomike dhe sociale

KESE mban lidhje të rregullta me këshillet rajonale dhe nacionale ekonomike dhe sociale në mbarë Bashkimin Evropian. Këto marrëdhënie, çdo vjet përfshijnë kryesisht këmbimin e informatave dhe diskutimet e përbashkëta mbi tema të caktuara.

Komiteti i Rajoneve

Zëri i pushtetit lokal

- Roli:** Të përfaqësojë qytetet dhe rajonet e Evropës
- Anëtarë:** 344 nga të gjitha Shtete Anëtare të BE-së
- Vendi:** Bruksel
- ▶ cor.europa.eu

Komiteti i Rajoneve (CoR) është organ këshillues që përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve rajonale dhe lokale të Evropës. Ai u ofron rajoneve të Evropës rol në politikëbërjen e BE-së dhe kontrollon nëse respektohen identitetet, kompetencat dhe nevojat rajonale dhe lokale. Këshilli dhe Komisioni duhet të konsultohen me Komitetin e Rajoneve për çështje që kanë të bëjnë me pushtetin lokal dhe rajonal, siç është politika rajonale, mjedisi, arsimit dhe transporti.

Çfarë bën Komiteti i Rajoneve

Meqë tre të katërtat e legjislacionit të BE-së implementohen në nivel lokal ose rajonal, ka logjikë që përfaqësuesit lokalë dhe rajonalë të kenë një rol në zhvillimin e ligjeve të reja të BE-së. Me përfshirjen e përfaqësuesve të zgjedhur lokalë, të cilët janë ndoshta më afër qytetarëve të Evropës dhe shqetësimeve të tyre, Komiteti i Rajoneve paraqet forcë për një BE më demokratike dhe më të përgjegjshme.

Komisioni dhe Parlamenti Evropian janë të obliguar të konsultohen me Komitetin e Rajoneve lidhur me propozimet legjislative në fushat e politikave që ndikojnë drejtpërdrejt të autoritetet lokale dhe rajonale — për shembull, mbrojtja civile, ndryshimi i klimës dhe energjia. Kur Komiteti i Rajoneve merr propozimin legjislativ, anëtarët diskutojnë atë në seancë plenare, e miratojnë me shumicë votash dhe nxjerrin një opinion. Është me rëndësi se Komisioni dhe Parlamenti nuk janë të obliguar të ndjekin këshillën e Komitetit të Rajoneve, mirëpo janë të detyruar të konsultohen me të. Nëse konsultimi i duhur obligues në procesin legjislativ është injoruar, Komiteti i Rajoneve ka të drejtë të sjellë veprime para Gjykatës së Drejtësisë. Komiteti i rajoneve, me iniciativën e vet, mund të ofrojë edhe opinione lidhur me çështjet aktuale.

Si funksionon Komiteti i Rajoneve

Anëtarët e Komitetit janë politikanë të votuar komunalë ose rajonalë, të cilët përfaqësojnë një varg të tërë të aktiviteteve të qeverisjes lokale dhe rajonale në BE. Ata mund të jenë presidentë rajonalë, parlamentarë rajonalë, këshilltarë të qytetit ose kryetarë komunalë të qyteteve të mëdha. Të gjithë duhet të kenë një mandat politik në vendin e tyre të origjinës. Ata nominohen nga qeveritë e BE-së, mirëpo punojnë me pavarësi të plotë politike. Këshilli i emëron me mandat për pesë vjet dhe kanë mundësi për t'u rimëruar. Komiteti i Rajoneve emëron presidentin nga radhët e veta, me mandat prej dy vjet e gjysmë.

Anëtarët e Komitetit të Rajoneve jetojnë dhe punojnë në rajonet e tyre. Ata takohen në Bruksel pesë herë në vjet për seanca plenare, gjatë të cilave përcaktohen politika dhe miratohen opinione. Gjashtë komisione të specializuara, të cilat përbëhen nga anëtarë të Komitetit të Rajoneve, përfshijnë fusha të politikave të ndryshme dhe përgatisin seancat plenare:

- ▶ Komisioni për Politikën e Kohezionit Territorial (COTER);
- ▶ Komisioni për Politikë Ekonomike dhe Sociale (ECOS);
- ▶ Komisioni për Zhvillim të Qëndrueshëm (DEVE);
- ▶ Komisioni për Arsim, Rini dhe Hulimtim (EDUC);
- ▶ Komisioni për Mjedis, Ndryshim të Klimës dhe Energji (ENVE);
- ▶ Komisioni për Shtetësi, Qeverisje, Çështje të Jashtme dhe Institucionale (CIVEX);
- ▶ Komisioni për Resurse Natyrore (NAT).

Anëtarët e Komitetit të Rajoneve gjithashtu grupohen në delegacione nacionale, një për çdo Shtet Anëtar. Ekzistojnë edhe grupet ndër-rajonale, të cilat inkurajojnë bashkëpunimin ndërkuftar. Përveç kësaj, ekzistojnë katër grupime politike.

Avokati i Popullit Evropian

Shqyrtimi i ankesave tuaja

Roli: Të hetojë keqadministrimin

Vendi: Strasburg

► ombudsman.europa.eu

Avokati i Popullit Evropian shqyrton ankesat në lidhje me rastet e administrimit të dobët apo të dështuar (keqadministrimit) të institucioneve të BE-së. Avokati i Popullit pranon dhe shqyrton ankesa nga qytetarët, banorët, bizneset dhe institucionet e BE-së.

Çfarë bën Avokati i Popullit

Avokati i Popullit zgjidhet nga Parlamenti Evropian për një mandat prej pesë vjetësh me mundësi për rizgjedhje. Me pranimin dhe hetimin e ankesave, Avokati i Popullit ndihmon për të zbuluar keqadministrimin në institucionet evropiane dhe organet e tjera të BE-së — me fjalë të tjera, hetimin e rasteve kur institucionet e BE-së dështojnë të bëjnë diçka që duhet bërë; e bëjnë atë në mënyrë të gabuar, ose bëjnë diçka që nuk duhet bërë. Shembujt e keqadministrimit përfshijnë:

- padrejtësi;
- diskriminim;
- keqpërdorim i pozitës;
- mungesë ose refuzim i informacionit;
- vonesë e panevojshme;
- procedura të pasakta.

Çdo shtetas ose banor i një Shteti Anëtar të BE-së mund të bëjë një ankesë te Avokati i Popullit, ashtu si mund të bëjë çdo shoqatë ose biznes. Avokati i Popullit merret vetëm me institucionet dhe organet e BE-së, dhe jo me ankesat kundër autoriteteve ose institucioneve qeveritare nacionale, rajonale ose lokale. Ai operon në mënyrë plotësisht të pavarur dhe të paanshme dhe nuk kërkon ose nuk pranon udhëzime nga asnjë qeveri ose organizatë.

Shpesh, Avokati i Popullit duhet të informojë institucionin në fjalë në lidhje me ankesën, në mënyrë që ai të zgjidhë problemin. Nëse zgjidhja e rastit nuk është e kënaqshme gjatë hetimeve, Avokati i Popullit do të mundohet, nëse është e mundur, të gjejë zgjidhje miqësore e cila përmirëson rastin e keqadministrimit dhe ofron zgjidhje të kënaqshme për ankuesin. Nëse kjo dështon, Avokati i Popullit mund të japë rekomandime për zgjidhjen e rastit. Nëse institucioni në fjalë nuk pranon rekomandimet e tij, ai mund të hartojë një raport special për Parlamentin Evropian.

Faqja e internetit e Avokatit të Popullit ka një doracak praktik për mënyrën e paraqitjes së ankesës.



Në rolin e Ombudsmanit, Nikiforos Diamanduros shqyrton ankesat për administratën e keq ose të dështuar në sistemin e BE-së.

© ImageGlobe

Organi Mbikqyrës Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave

Mbrojtja e privatësisë suaj

Roli: Të mbrojtë të dhënat personale të qytetarëve të përpunuara nga institucionet dhe organet e BE-së

Vendi: Bruksel

► edps.europa.eu

Në rrjedhën e punës së tyre, institucionet evropiane mund të ruajnë dhe të përpunojnë të dhënat personale për qytetarët dhe banorët e BE-së në format elektronik, me shkrim ose vizual. Organi Mbikqyrës Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave (EDPS) është i ngarkuar me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë e njerëzve, dhe ka për detyrë të promovojë përvojat e mira të kësaj fushe nëpër institucionet dhe organet e BE-së.

Çfarë bën organi Mbikqyrës Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave

Rregulla të rrepta evropiane administrojnë përdorimin e të dhënave personale të qytetarëve nga institucionet e BE-së, siç janë emrat, adresat, të dhënat shëndetësore ose historia e punësimit. Mbrojtja e këtyre informatave është e drejtë fundamentale. Çdo institucion i BE-së ka një nëpunës për mbrojtjen e të dhënave, i cili siguron se respektohen obligimet e caktuara — për shembull, se të dhënat mund të përpunohen vetëm për arsye të veçanta dhe të ligjshme. Për më tepër, personi, të dhënat e të cilit janë duke u përpunuar, ka të drejta të caktuara të zbatueshme, siç është e drejta e korrigjimit të të dhënave. Detyra e EDPS-së është të mbikqyrë aktivitetet dhe sistemet për mbrojtjen e të dhënave të institucioneve të BE-së dhe të sigurojë se përputhen me përvojën më të mirë. EDPS-ja gjithashtu trajton ankesat dhe kryen hetime. Detyra të tjera përfshijnë:

- mbikqyrja e përpunimit të të dhënave personale nga administrata e BE-së;
- këshillimi lidhur me politikat dhe legjislacionin që ndikon në privatësi;
- bashkëpunimi me autoritete të ngjashme në Shtetet Anëtare, për të siguruar mbrojtjen e vazhdueshme të të dhënave.

Si funksionon EDPS

Për funksionimin e përditshëm, EDPS përbëhet nga dy entitete. Mbikqyrja dhe Zbatimi vlerëson respektimin e mbrojtjes të të dhënave nga institucionet dhe organet e BE-së. Politika dhe Konsultimi këshillojnë ligjvënësin e BE-së lidhur me çështjet e mbrojtjes së të dhënave në disa fusha të politikave dhe në propozime për legjislacion të ri. EDPS-ja gjithashtu monitoron teknologjitë e reja që mund të kenë ndikim në mbrojtjen e të dhënave.

Kushdo që mendon se të drejtat e tij apo të saj janë shkelur kur një institucion ose organ i BE-së ka përpunuar të dhëna që kanë të bëjnë me atë, ai ose ajo mund t'i ankohen Mbikqyrësit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave. Ankesa duhet të bëhet përmes plotësisht të një formulari për dorëzim të ankesës, i cili ndodhet në ueb faqen e EDPS-së.

Banka Evropiane e Investimeve

Investimi në të ardhmen

- Roli:** Të mundësojë financat afatgjate për investime në projekte që kanë të bëjnë me BE-në
- Pjesëmarrës:** Shtetet Anëtare të BE-së
- Bordi i drejtorëve:** Një nga çdo Shtet Anëtar plus Komisioni Evropian
- Vendi:** Luksemburg
- www.eib.org

Banka Evropiane e Investimeve (BEI) është Banka e Bashkimit Evropian. Ajo është pronësi e Shteteve Anëtare dhe misioni i saj është të huazojë para për investime që përkrahin synimet e Bashkimit Evropian — për shembull, në fushën e rrjeteve të energjisë dhe transportit, qëndrueshmërinë e mjedisit dhe inovacionit. Fokusi i BEI-së është rritja e vendeve të punës dhe potencialit zhvillimor në Evropë, përkrahja e veprimeve lidhur me klimën dhe përkrahja e politikave të BE-së përtej kufijve të vet.

Çfarë bën BEI

Banka Evropiane e Investimeve është huadhënësi dhe kreditori më i madh multilateral, që ofron financa dhe ekspertizë për projekte të shëndosha dhe të qëndrueshme investimi, kryesisht në BE. Linjat TGV (trenat e shpejtë) dhe Viaduk de Milau në Francë, mbrojtja nga vërshimet në Venedik, mullinjtë e erës në Britani të Madhe, ura Oresund në Skandinavi, metroja e Athinës, pastrimi i Detit Baltik janë vetëm disa nga mijëra projektet e financuara nga BEI gjatë viteve.

BEI nuk përdor paratë nga buxheti i BE-së. Ajo financon vetveten me anë të lëshimit të bonove në tregjet financiare botërore. Në vitin 2011, BEI huazoi 61 miliardë euro për 450 projekte të mëdha në 78 vende — 54 miliardë euro në Shtetet Anëtare të BE-së dhe 7 miliardë euro jashtë BE-së, me fokus në vendet para-anëtarësimit, fqinjët jugorë dhe lindorë të Evropës, Afrikën, Karaibet dhe Paqësorin, si dhe Amerikën Latine dhe Azinë.

BEI është vlerësuar me AAA. BEI zakonisht huazon deri në 50 % të kostos së projektit. Duke vepruar si një katalizator, ajo tërheq kofinancimin nga burime të tjera. Për kredi mbi 25 milionë euro, BEI huazon drejtpërsëdrejti në organet shtetërore dhe ato të sektorit

publik, siç janë qeveritë dhe ndërmarrjet. Për kredi më të vogla, BEI mundëson linja kreditore për bankat komerciale dhe institucione të tjera financiare, të cilat pastaj i huazojnë fondet e BEI-së për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ose projektet më të vogla të ndërmarra nga huamarrësit e sektorit publik.

Brenda BE-së, BEI ka gjashtë prioritetet për aktivitetet e veta të kreditimit:

- Përmirësimi i kohezionit dhe konvergjenca midis vendeve dhe rajoneve të BE-së;
- Përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit dhe komuniteteve të qëndrueshme;
- Zbatimi i ekonomisë së njohurive;
- Ndihma në zhvillimin e Rrjeteve Tej-Evropiane për transport dhe energji (TEN);
- Krijimi i furnizimeve të qëndrueshme, konkurruese dhe të sigurta të energjisë.

Si funksionon BEI

BEI është institucion autonom që merr vet vendimet e huamarrjes dhe kreditimit sipas meritave të çdo projekti veçmas dhe në bazë të mundësive të ofruara nga tregjet financiare. Banka bashkëpunon me institucionet e tjera të BE-së, sidomos me Komisionin Evropian, Parlamentin Evropian dhe Këshillin e Ministrave.

Vendimet e Bankës Evropiane të Investimeve merren nga organet në vijim:



© ImageGlobe

Ndërtimi i linjave të reja hekurudhore është mes atyre projekteve që mund të përfitojnë nga huatë e Bankës Evropiane për Investime.

- Bordi i Guvernatorëve përbëhet nga ministra (normalisht ministrat e financave) të të gjitha Shteteve Anëtare. Ky bord përcakton politikën e përgjithshme të Bankës për kreditim.
- Bordi i Drejtorëve, i kryesuar nga Presidenti i Bankës, përbëhet nga 28 anëtarë, 27 të emëruar nga Shtetet Anëtare dhe një nga Komisioni Evropian. Ky bord miraton operacionet e huamarrjes dhe kreditimit.
- Komiteti i Menaxhimit është organi me orar të plotë ekzekutiv i Bankës. Ky komitet trajton punën e përditshme të BEI-t.

Fondi Evropian për Investime

BEI është aksioneri kryesor në Fondin Evropian të Investimeve (EIF) që financon investimet në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat përbëjnë 99 % të ndërmarrjeve në BE dhe punësojnë mbi 100 milionë evropianë. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme shpesh e kanë shumë vështirë të marrin financat e nevojshme për të investuar dhe për t'u zhvilluar. Kjo vlen sidomos për bizneset e reja dhe ndërmarrjet e vogla me produkte apo shërbime inovative — pikërisht ato NVM sipërmarrëse që BE-ja don t'i inkurajojë. Fondi Evropian për Investime plotëson këto nevoja përmes kapitalit dhe instrumenteve për rrezik financiar — që arrijnë vlerën në disa miliardë euro në vjet — pjesërisht të ofruara në partneritet me Komisionin Evropian, bankat komerciale dhe huadhënës të tjerë.

- www.eif.org

Agjencitë e BE-së

Ekzistojnë disa agjenci të specializuara të Bashkimit Evropian, të cilat ofrojnë informata apo këshilla për institucionet e BE-së, Shtetet Anëtare dhe për qytetarët. Secila nga këto agjenci ka një detyrë të veçantë teknike, shkencore ose menaxhuese. Agjencitë e BE-së mund të grupohen në disa kategori.

► Agjencitë e decentralizuara

Agjencitë janë organe të qeverisura sipas ligjit publik evropian, mirëpo dallojnë nga institucionet e BE-së (Këshilli, Parlamenti, Komisioni, etj.) dhe kanë personalitetin e vet ligjor. Ato kanë zyra nëpër qytete të ndryshme në mbarë Evropën, dhe prandaj shpesh quhen të 'decentralizuara'. Ato mund të trajtojnë detyra të natyrës ligjore ose shkencore. Shembuj janë Zyra e Varieteteve Bimore në Angers në France e cila përcakton të drejtat për varietetet e reja të bimëve, ose Qendra Monitoruese për Drogë dhe Varësi në Lisbonë në Portugali, e cila analizon dhe shpërndan informata lidhur me drogën dhe varësinë nga droga.

Tre organe mbikqyrëse ndihmojnë për të zbatuar rregullat për institucionet financiare dhe në këtë mënyrë ruajnë stabilitetin e sistemit financiar të Evropës. Ato janë Autoriteti Bankar Evropian, Autoriteti Evropian për Sigurime dhe Pensione Profesionale, dhe Rregullatori Evropian i Tregjeve dhe Letrave me Vlerë.

Agjencitë e tjera u ndihmojnë Shteteve Anëtare të BE-së të bashkëpunojnë në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar. Një shembull është Europol, me seli në

Hagë në Holandë, i cili ofron një platformë për punën e përbashkët të zyrtarëve të zbatimit të ligjit nga vendet e BE-së. Ata ndihmojnë njëri-tjetrin për të identifikuar dhe ndjekur rrejetet më të rrezikshme kriminale dhe terroriste në Evropë.

Tre agjencitë kryejnë detyra shumë specifike në suaza të politikës së përbashkët të Bashkimit Evropian për politikë të jashtme dhe siguri. Qendra Satelitore e Bashkimit Evropian me seli në Torrejón de Ardoz në Spanjë është një agjenci e tillë; ajo përdor informata nga satelitët që vëzhgojnë tokën, për të mbështetur vendim-marrjen e BE-së në çështjet e jashtme dhe të sigurisë.

► Agjencitë dhe organet Euratom

Këto organe punojnë në suaza të kornizës së Traktatit të Komunitetit Evropian për Energji Atomike (Euratom) për të koordinuar hulumtime nëpër vendet e BE-së, për përdorimin paqësor të energjisë bërthamore dhe për të siguruar se furnizimi i energjisë atomike është i mjaftueshëm edhe i sigurt.

► Agjencitë ekzekutive

Agjencitë ekzekutive sigurojnë menaxhimin praktik të programeve të BE-së, si për shembull trajtimin e kërkesave për grante nga buxheti i BE-së. Ato themelohen për një periudhë të caktuar kohore dhe duhet të jenë të vendosura në të njëjtin vend me Komisionin Evropian; Bruksel ose Luksemburg. Një shembull është Këshilli Evropian për Hulumtim i cili financon hulumtimet themelore të grupeve të shkencëtarëve nga BE-ja.

Siguria e ushqimit tonë duhet të kontrollohet në mbarë Evropën – koordinimi i kësaj pune është detyrë tipike e një agjencie të BE-së.



Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER)

Zyra e Organit të Rregullatorëve Evropianë për Komunikim Elektronik (BEREC)

Zyra e Komunitetit për Varietetin e Bimëve (CPVO)

Agjencia Ekzekutive Arsimore, Audiovizuale dhe Kulturore (EACEA)

Agjencia Ekzekutive për Konkurrencë dhe Inovacion (EACI)

Agjencia e Furnizimit Euratom (ESA)

Agjencia Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operativ në Kufijtë e Jashtëm (Frontex)

Agjencia Evropiane për menaxhimin operativ të sistemeve të mëdha të Teknologjive të Informimit në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë (IT Agency)

Agjencia Evropiane për Siguri dhe Shëndet në Punë (EU-OSHA)

Zyra Evropiane për Mbështetje të Azilit (EASO)

Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit (EASA)

Autoriteti Bankar Evropian (EBA)

Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC)

Qendra Evropiane për Zhvillimin e Trajnimit Profesional (Cedefop)

Agjencia Evropiane e Kimikateve (ECHA)

Agjencia Evropiane e Mbrojtjes (EDA)

Agjencia Evropiane e Mjedisit (EEA)

Agjencia Evropiane për Kontrollin e Peshkimit (EFCA)

Autoriteti Evropian për Sigurinë e Ushqimit (EFSA)

Fondacioni Evropian për Përmirësimin e Kushteve të Punës dhe të Jetës (Eurofound)

Agjencia Evropiane GNSS (GSA)

Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE)

Instituti Evropian për Inovacion dhe Teknologji (EIT)

Autoriteti Evropian për Sigurim dhe Pensione profesionale (EIOPA)

Ndërmarrja e Përbashkët Evropiane për ITER dhe Zhvillimi i Energjisë Fuzionale (Fusion for Energy)

Agjencia Evropiane për Siguri Detare (EMSA)

Agjencia Evropiane e Barnave (EMA)

Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogë dhe Varësi nga Droga (EMCDDA)

Agjencia Evropiane e Sigurisë së Rrjeteve dhe Informacionit (ENISA)

Kollexhi Evropian i Policisë (CEPOL)

Zyra Evropiane e Policisë (Europol)

Agjencia Evropiane e Hekurudhave (ERA)

Agjencia Ekzekutive e Këshillit Evropian për Hulumtim (ERCEA)

Autoriteti Evropian i Tregjeve dhe Letrave me Vlerë (ESMA)

Fondacioni Evropian për Trajnime (ETF)

Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejta Fundamentale (FRA)

Instituti i Bashkimit Evropian për Studime të Sigurisë (EUISS)

Qendra Satelitore e Bashkimit Evropian (EUSC)

Njësia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim Gjyqësor (Eurojust)

Agjencia Ekzekutive për Shëndetësi dhe Konsumatorë (EAHC)

Zyra e Harmonizimit në Tregun e Brendshëm (Shenjat tregtare dhe dizajni) (OHIM)

Agjencia Ekzekutive e Hulumtimit (REA)

Agjencia Ekzekutive e Rrjetit për Transport Trans-Evropian (TEN-T EA)

Qendra e Përkthimit për Organet e Bashkimit Evropian (CdT)

Të gjitha agjencitë e BE-së mund të gjenden nëpërmjet ► europa.eu/agencies/index_en.htm

Kontaktimi me BE-në

ONLAJN



Informata në të gjitha gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian mund të gjeni në ueb faqen Europa: europa.eu

PERSONALISHT



Në mbarë Evropën ka qindra qendra lokale informative të BE-së. Adresën e qendrës më të afërt mund ta gjeni në ueb faqen Europe Direct: europedirect.europa.eu

PËRMES TELEFONIT OSE POSTËS



Europe Direct është shërbim që u përgjigjet pyetjeve tuaja lidhur me Bashkimin Evropian. Këtë shërbim mund ta kontaktoni në telefonin pa pagesë **00 800 6 7 8 9 10 11**, telefonin me pagesë nëse merrni nga vendet jashtë BE-së **+32 2 299 96 96** ose me anë të postës elektronike të ueb faqes Europe Direct: europedirect.europa.eu



LEXONI MBI EVROPËN

Për të lëxuar botimet mbi BE-në, vetëm duhet të klikoni një herë në ueb faqen e librisë të BE-së: bookshop.europa.eu

Qendra Informative e Unionit Evropian

M.H.Jasmin 52v, 1000 Shkup
Tel/faks. 02/3296-363
Internet: www.euic.mk
e-mail: euinfo@euic.mk

Delegacioni i Bashkimit Evropian

M.H.Jasmin 52v, 1000 Shkup
Tel. 02/3248 500
Faks. 02/3248 501
www.eeas.europa.eu/delegations/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia
e-mail: Delegation-FYRMacedonia@ec.europa.eu

Pika Informative e UE-së, Manastir

Komuna e Manastirit
Qendra Informative e Komunës
Adresa: bul. "1 Maj" bb, 7000 Manastir
Tel. (+389 047) 208336
e-mail: bitola@euinfopoint.mk

Pika Informative e UE-së, Veles

Komuna e Velesit
Adresa: rr. "Panko Brashnar" nr. 1
1400 Veles
Tel. (+389 043) 232 406 lok. 226
e-mail: veles@euinfopoint.mk

Pika Informative e UE-së, Gostivar

Komuna e Gostivarit
Qendra Informative e Komunës
Adresa: Bul. "Braqa Gjinovski" nr. 61
1230 Gostivar
Tel. (+389 042) 218 167
e-mail: gostivar@euinfopoint.mk

Pika Informative e UE-së, Kavadarci

Komuna e Kavadarcit
Adresa: "Marshal Tito" bb, 1430 Kavadarci
Tel. (+389 043) 400217
(+389 043) 456107
e-mail: kavadarci@euinfopoint.mk

Pika Informative e UE-së, Koçani

Komuna e Koçanit
Qendra Informative e Komunës
Adresa: "Rade Kratovce" 1, 2300 Koçani
Tel. (+389 033) 279554
e-mail: kocani@euinfopoint.mk

Pika Informative e UE-së, Kumanovë

Komuna e Kumanovës
Qendra Informative e Komunës
Adresa: "11 Oktovri" bb, 1300 Kumanovë
tel/faks: (+389 031) 475 800
(+389 031) 475817
(+389 031) 432 650
e-mail: kumanovo@euinfopoint.mk

Pika Informative e UE-së, Tetovë

Komuna e Tetovës
Adresa: rr. "Dervis Cara" bb, 1200 Tetovë
Tel. 070 548 576
e-mail: tetovo@euinfopoint.mk

Pika informative e BE-së në Librarinë Nacionale dhe Univerzitare "Shn. Kliment Ohridski"

Adresa: bul. Goce Delchev br. 6, 1000 Shkup
Tel. (+389 02) 3226 846
e-mail: nul@euinfopoint.mk

Pika Informative e BE-së në Gjevgjeli

Adresa: Rru. "Dimitar Vllahov" 4,
Tel. 034 213 843, 1480 Gjevgjeli
e-mail: gevgejlja@euinfopoint.mk

Pika Informative e BE-së në Ohër

Adresa: Rru. "Dimitar Vllahov" 57,
Tel. 046 230 175, 6000 Ohër
e-mail: ohrid@euinfopoint.mk

Pika Informative e BE-së në Dibër

Adresa: Rru. "8mi Septemvri" bb, 1250 Dibër
Tel. 046 831 196
e-mail: debar@euinfopoint.mk

Pika Informative e BE-së në Strumicë

Adresa: "Blagoj Muçeto" 26, 2400 Strumicë
Tel. 034 349 040
e-mail: strumica@euinfoport.mk

Pika Informative e BE-së në Kriva Pallankë

Adresa: "St. Joakim Osogovski" 175,
1330 Kriva Pallankë
Tel. 031 375 035
e-mail: krivapalanka@euinfoport.mk

EUj – FAKULTETI EKONOMIK SHKUP

Adresa: Fakulteti ekonomik, Universiteti "Shë Kirili dhe Metodi",
bul. "Krste Misirkov" pn, 1000 Shkup
Tel. (+389 02) 3286 835
Tel. (+389 02) 3286 860
e-mail: eui-sk@eccf.ukim.edu.mk

EUj – Fakulteti për administrimin dhe menaxhimin e sistemeve informatike

Adresa: Fakulteti për administrimin dhe menaxhimin e sistemeve informatike,
Universiteti "Shën Kliment Ohridski",
"Partizanska" pn, 7000 Manastir
Tel. (+389 047) 259923
Faks. (+389 047) 259 917
e-mail: eui-bt@famis.edu.mk

EUj – UNIVERSITETI I EUROPËS JUGLINDORE, TETOVË

Adresa: Universiteti i Europës Juglindore,
"Ilindenska" pn, 1200 Tetovë
Tel. (+389 044) 356205
faks. (+389 044) 356 001
e-mail: eui-te@seeu.edu.mk

Bashkimi Evropian



Bashkimi Evropian (BE) është unik. Nuk është një shtet federal si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sepse vendet e tij anëtare mbeten kombe të pavarura dhe sovrane. As nuk është një organizatë thjesht ndërqeveritare si Kombet e Bashkuara, për shkak se vendet anëtare bashkojnë një pjesë të sovranitetit të tyre — dhe kështu fitojnë fuqi dhe ndikim më të madh kolektiv se sa që do të kishin pasur nëse vepronin individualisht.

Ata bashkojnë sovranitetin e tyre duke marrë vendime të përbashkëta përmes institucioneve të përbashkëta, të tilla si Parlamenti Evropian, i cili zgjidhet nga qytetarët e BE-së, si dhe Këshilli Evropian dhe Këshilli, të cilat përfaqësojnë qeveritë kombëtare. Ato vendosin në bazë të propozimeve të Komisionit Evropian, i cili përfaqëson interesat e BE-së në tërësi. Çfarë bën secili nga këto institucione? Si punojnë këto institucione së bashku? Kush është përgjegjës për çfarë?

Kjo broshurë i përgjigj këto pyetje në një gjuhë të qartë dhe të thjeshtë. Ajo gjithashtu jep një pasqyrë të shkurtër të agjencive dhe organeve të tjera që janë të përfshira në punën e Bashkimit Evropian. Qëllimi është që t'u ofrojmë një udhëzues të dobishëm për vendim-marrjet e BE-së.

